

## Procesverbal

*Nga Mbledhja IV (e katërt) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Dragashit, e mbajtur më datë: 29.04.2025*

### *Rend Dite*

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Raporti për realizimin e buxhetit për periudhën janar-mars 2025;
3. Anulimi i Vendimit për financimin e shujtave ditore për nëpunësit e shërbimit civil të Administratës së Komunës së Dragashit 01 Nr.060.01-7/25 të datës 28.02.2025;
4. Shqyrtimi i kërkesës së OVL të UÇK-së për ndryshimin e datës zyrtare të çlirimit të Komunës së Dragashit, nga data 15 në 12 qershor.
5. Formimi i komisionit për verifikimin e procedurave të blerjes dhe servisimit të automjeteve të QKMF-së; dhe
6. Eventuale.

**Arijeta Skeraj:** I nderuar kryetar, kolegë asambleistë, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të mediave, të nderuar të pranishëm! Ju uroj mirëseardhje në seancën e katërt të rregullt të Kuvendit për vitin 2025! Besoj që materialin për këtë seancë e keni pranuar me kohë dhe keni pasur mundësi të njiheni me përmbajtjen e tyre. Në rend të ditës kemi gjithsej katër pika, të cilat i keni marrë së bashku me ftesën për këtë mbledhje. Të nderuar kolegë, dëshiroj të ndalem pak në një që lidhet me funksionimin e seancave tona, në përgatitjen e rendit të ditës. Siç e dini, në disa nga seancat e kaluara është kërkuar nga delegatët që të përfshihet pika eventuale, që shërben për parashtrimin e pyetjeve, komenteve apo shqetësimeve që nuk janë përfshirë në pikat formale të rendit të ditës. Megjithatë, kemi pasur raste kur janë parashtruar pyetje nga asambleistët, por të njëjtit nuk kanë qëndruar në seancë për t'i dëgjuar përgjigjet. Dua të ju kujtoj se, edhe pse ka pasur mungesë të kuorumit, në disa raste, unë personalisht kam vendosur ta vazhdoj seancën, vetëm që të mos mbetemi pa përgjigje dhe që ta ruajmë një formë bashkëpunimi e transparence. Megjithatë, në seancën e fundit jemi gjendur në një situatë të paprecedent. Seanca është zhvilluar me katër apo pesë asambleistë të pranishëm, çka është në kundërshtim të plotë me normat ligjore dhe me etikën institucionale. Për këtë arsye, për ta ruajtur integritetin e punës sonë si organ përfaqësues, këtë herë nuk e kam përfshirë në rend të ditës pikën eventuale. Ky vendim nuk është marrë për të kufizuar të drejtën e fjalës së askujt, por për të garantuar që puna jonë të zhvillohet në mënyrë të rregullt, të drejtë dhe me pjesëmarrje të barabartë. Shpresoj në mirëkuptimin tuaj dhe pres që në

seancën e ardhshme të kemi një angazhim më të madh për të respektuar institucionin dhe pjesëmarrjen aktive në të gjitha fazat e seancës. Në qoftë se dëshironi ju, asambleistë, që pika eventuale të vendoset dhe të jeni prezentë, unë kërkesën tuaj do ta qes edhe në votim. Para se me e qit në votim rendin e ditës, a do dikush me e marrë fjalën?

**Nedžmidin Sejdilar:** Sa i përket pikës së eventualiteteve dhe mungesës së delegatëve në atë pikë, kjo varet nga vetë asamblistët. Kur ju ka konvnuar, keni përfunduar atë pikë me tre asamblistë. Ajo që dua të propozoj ka të bëjë me ndërtimin e fabrikës për shkrirjen e kromit, të cilën herën e kaluar e keni hequr nga rendi i ditës. Kërkoj që të marrim vendim që Kuvendi Komunal të mos pranojë më kërkesa të tilla për ndërtimin e kësaj fabrike, ashtu siç kemi marrë vendim në vitin 2018 për të mos dhënë pëlqim për ndërtimin e mini-hidrocentraleve. Duke pasur parasysh që komuna jonë është komunë ekologjike me park kombëtar, kërkoj që të merret një vendim i tillë. Çështja e dytë: Kërkoj që të përfshihet në rendin e ditës formimi i një komisioni për hetimin e gjendjes së automjeteve në QKMF. Çështja e tretë: Kërkoj që të shqyrtohet mundësia për ndërhyrje në rrugën ndërmjet fshatrave Krushevë dhe Globoqicë, për shkak të rrëshqitjeve të dheut dhe gurëve në atë segment rrugor.

**Arijeta Skeraj:** Nedžmidin, nëse bën edhe një herë kërkesën e dytë dhe të tretë!

**Nedžmidin Sejdilar:** Zonja kryesuese, nëse e keni përkthimin keq, unë ju them edhe shqip, nuk e kam telashe. Kërkesa e parë e imja ishte: Ne, siç e kemi parë, në seancën e kaluar e kemi hequr nga rendi i ditës ndërtimin e fabrikës. Kërkesa ime është tash të futet në rendin e ditës pika, ku Kuvendi do të ndalojë këso lloj kërkesa, siç e ka bërë me hidrocentralet në 2018-tën. Me ndalesën e këtyre kërkesave, ne e zgjidhim problemin një herë e përgjithmonë, sepse Komuna jonë është një komunë me potencial turistik, me potencial bujqësor, edhe është e rrethuar me parkun nacional. Kjo ka qenë kërkesa e parë. Kërkesa e dytë, znj.kryesuese, ka qenë komisioni që e premtuat edhe ju, që do ta bëjmë për QKMF-në, lidhur me blerjen e atyre pesë veturave jo më të vjetra se tri vjet. Ta formojmë një komision, ta shikojmë, ta kontrollojmë, a ekzistojnë ato veturat, qysh janë, edhe ta bëjmë një raport. Edhe kërkesa ime e tretë ishte rrëshqitja e gurëve në mes të Globoqicës dhe Krushevës, ta formojmë një grup punues edhe ta kqyrim qysh me rregullue atë çështje, sepse ajo rrugë, kur është shi e kur është borë, është me të vërtetë rrezik për banorët që kalojnë atje. Unë e di që mirëmbajtja e rrugës nuk është punë e Komunës, por Komuna mundet me e bo një fond, me qit ndonjë rrethojë, ndonjë send, me e rregullu atë çështje. Ju faleminderit shumë!

**Shpetim Hajredini:** Përshëndetje i nderuar ekzekutiv, të nderuar kolegë/e asambleistë, të nderuar qytetarë të Dragashit! Së pari dua të lidhem patjetër me çështjen e largimit të pikës eventuale nga kjo seancë. E nderuar kryesuese, nuk është gjest i mirë largimi i pikës eventuale nga seanca. Ju është dashtë ta planifikoni edhe ta keni si pikë të rendit të ditës në këtë seancë edhe pikën eventuale dhe, natyrisht, nëse e kishim parë të arsyeshme ne këtu që kishim pas vonesa, apo e shohim që nuk është e nevojshme të mbahet pika eventuale, do ta largonim me votim. Por, ju nuk është mirë që ta largoni vetë. Ne jemi këtu për të vendosur për pikën eventuale, ta largojmë apo jo. Edhe, nuk po e shoh të arsyeshme arsyetimin tuaj që e potencuat më herët se nuk po qëndrojmë ne edhe nuk po presim t'i marrim përgjigjet nga ekzekutivi. Ata të cilët nuk presin t'i marrin përgjigjet, ajo është përgjegjësi e tyre edhe mbetet në ndërgjegjen e tyre. E bëjnë pyetjen, s'dojnë me e marrë përgjigjen, ju ia jepni përgjigjen, tash qytetarët e dëgjojnë përgjigjen edhe pyetjen e asambleistit. Por unë besoj që ne shumica këtu që bëjmë pyetje, i presim edhe përgjigjet. Ka disa prej atyre, ndoshta, që ndonjë seancë e bëjnë pyetjen, pastaj kanë ndonjë punë, iu del ndonjë punë dhe largohen e nuk qëndrojnë deri në fund të seancës. Por besoj që një pjesë e mirë e jona që jemi më aktivë në Asamble, qëndrojmë deri në fund. Andaj unë kisha dashtë, edhe kisha shkue edhe me propozim, që të jetë pika eventuale edhe në këtë seancë. Edhe në vazhdimësi, deri në përfundim të këtij mandati. Tjetra, e dha një propozim kolegu Nedžmidin, po besoj që e pat vetëm për çështjen e investimeve që kanë të bëjnë me shkrirjen e kromit. Po shpresoj që ashtu është, se përndryshe ne jemi për investime dhe nuk jemi kundër investimeve. Dhe nëse merret një vendim, ndalohen investimet vetëm që i përkasin kësaj lëmie, shkrirjes së kromit, pasi që është shumë i dëmshëm për shëndetin e njeriut dhe në përgjithësi për natyrën, atëherë natyrisht që duhet të diskutohet. Një herë paraprakisht të marrim edhe mendime prej njerëzve profesionalë, dhe pastaj mund të marrim edhe vendim. Në të kundërtën, personalisht nuk kisha votue edhe nuk jam që t'i ndalojmë investimet në Komunë tonë, ne kemi nevojë për investime.

**Driton Ademi:** Përshëndetje për të gjithë! Kryesuese, unë e kam një kërkesë. Nëse nuk futet pika eventuale për me e diskutue një çështje për Agjencinë Kadastrale të Kosovës, një informim publik kryetari është mirë me na bo. Nëse nuk futet pika eventuale për me diskutue, është mirë me e fut një pikë të rendit të ditës për një informacion, besoj se është shumë e nevojshme për qytetarët me i ditë datat në të cilat kanë me u mbajt edhe vendin ku ka me u mbajt, që qytetarët të jenë prezentë në këto ditë. Po kërkoj, nëse nuk futet pika eventuale, atëherë kërkoj të futet me një pikë të re të rendit të ditës. Faleminderit!

**Artan Loshaj:** Përshëndetje për të gjithë! Edhe unë pajtohem me kolegun Shpetim për pikën eventuale, sepse dje në komitet kemi pasur debat me kryetarin dhe kryesuesen rreth kësaj çështjeje. Ju duhet me e ditë, kolegë - ata që nuk jeni në komitete - komitetet e kanë pas pikën eventuale, ndërsa kryesuesja bashkë me kryetarin, këta janë idhnakë të mëdhenj edhe e kanë bo me qëllim këtë, se na s'e paskna dëgjue kryetarin që kemi bo pyetje, nuk kemi rrit me i marrë përgjigjet. Ne i bëjmë pyetjet këtu, edhe përgjigjet i merr qytetari, edhe ky nuk është arsytim, është një gjest jo i mirë, i papranueshëm për ne dhe për të gjithë qytetarët. T'i tregojmë kryetarit edhe kryesueses se na – edhe në qoftë se nuk hy si pikë e rendit të ditës – do ta gjejmë mundësinë që shqetësimet e qytetarëve, edhe problemet e qytetarëve ne t'i shpalosim këtu. Nuk mundesh me na e marrë të drejtën për me diskutue, është mirë që propozimin e djeshëm edhe propozimin e Shpetimit sot, ta qesim në votim, pikën eventuale që të jetë si pikë e pestë e rendit të ditës.

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Atëherë, për pikën eventuale, as unë e as kryetari nuk jemi idhnakë, por personi që foli tash, ai ka bo pyetje edhe ndaj kryetarit, edhe ndaj kryesueses, edhe nuk ka prit me e marrë përgjigjen. Unë nuk mundem me e ditë qysh munden me dalë me e lyp ky pikën eventuale, kur në seancën e fundit ka bo pyetje dhe ka dalë. Atëherë, ishin disa propozime që të futen në rend të ditës. Ishin propozimet e Nedžmidin Sejdlar, ku e bëri një kërkesë që të gjitha kërkesat që vijnë për kromin, sot të merret një vendim që mos të pranojmë investitorë ne si Kuvend. E dyta ishte për formimin e komisionit për veturat e QKMF-së. Edhe propozimin e tretë e pat për grupin punues për rrëshqitjen e gurëve në rrugën Glloboqicë – Krushevë. Shpetim Hajredini e pati si kërkesë që pika eventuale të futet në rend të ditës, dhe e pat të njëjtën kërkesë si të z.Sejdilar për kromin. Dritoni e pat për Agjencinë Kadastrale, por pasi po e qesim një herë pikën eventuale, që nëse kalon, Dritoni e tha që kjo të diskutohet në pikën eventuale. Atëherë, para se me e qit rendin e ditës, po fillojmë me kërkesën e parë. Z.Sejdilar dhe z.Shpetim Hajredini, e njëta kërkesë ishte. Ne nuk mundemi me e qit këtë kërkesë në votim, për arsye se nuk mund t'ia ndalojmë asnjë investitori që të parashtrijë kërkesë. Në qoftë se doni me e qit, atëherë e qesim në votim. Kush është pro kërkesës së z.Sejdilar dhe z.Shpetim Hajredini, që të ndalohen këto kërkesa?

**Shpetim Hajredini:** Po më vjen shumë keq, se më keqkuptove po më duket në fjalimin tim. Unë nuk pata të bëj fare në fjalim timin me kërkesë për ndalim. E thashë unë, e mbështes nëse ka të bëjë diçka që është kundër shëndetit të njeriut, kundër natyrës, natyrisht që ne do të jemi kundër. Por, kundër investimeve nuk jemi. Po edhe kundër kësaj – unë thashë, kisha pas dëshirë, edhe nëse

diskutojmë, të ketë njerëz profesionalë të cilët na japin detaje dhe e kemi të qartë me të vërtetë se, për shembull, ky investim i cili na erdhi më herët është i dëmshëm. Edhe pse ne personalisht kemi lexue dhe po e dimë që është i dëmshëm. Por, kishte qenë më e arsyeshme që njerëz profesionalë të na japin sqarime në këtë drejtim. Nuk pata të bëj fare unë me propozim. Propozimi im është vetëm pika eventuale.

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit, Shpetim! Të kërkoj falje!

**Bexhet Xheladini:** E nderuar kryesuese, i nderuar zv.kryesues, të nderuar asambleistë, përfaqësues të OSBE-së, mjete të informimit! Lidhur me kërkesat e Nedžmidin Sejdilarit – kërkesën e parë – unë dua të them se kërkesa e tij që të futet në rend të ditës që t’ua ndalojmë kompanive që të konkurrojnë për çfarëdo lloj investimi, është antiligjore, edhe nuk është mirë bile edhe me e fut në rend të ditës këtë çështje. Edhe nëse e futim edhe votohet, Ministria na e kthen këtë si të paligjshme. Prandaj, nuk është e arsyeshme që të qitet edhe në votim. Sa i përket kërkesës për automjetet më të vjetra se tri vjet, unë sa jam kryetar nuk e di që QKMF-ja ka blerë ndonjë automjet të vjetër. Të gjitha automjetet QKMF i ka blerë të reja. Mirë, mundenim me e fut, unë jam për me e formue një komision. Një herë e përgjithmonë të ndalet gënjeshtria, rrenat, propagandat e Nežmidin Sejdilarit. Qe tri vite na ka lodhë me këto vetura, e unë e di që këtu nuk ka kurgjo të vërtetë, por këtë e bën me qëllime propagandistike dhe ka qëllime të caktuara. Ka personalisht probleme me drejtorin edhe ky don të hakmerret në forma të ndryshme, të propagandave dhe gënjeshtreve. Kështu që, lirisht mund të formohet një komision, të shkojë ta vërtetojë këtë. Po na kur kemi dashtë këtë me e vërtetue, vetë ky ka dalë, e ka lëshue Asamblenë, nuk ka dalë me ardhë e me dalë me i pa automjetet, edhe me u bind edhe vetë. Kjo nuk është problem, mundeni me e formue një komision, edhe një herë e përgjithmonë t’i mbyllet goja këtij për propagandat që po i bën. Sa i përket kërkesës së tretë, çështja e rrugës Dragash-Restelicë, në pjesën ku është problematike, ku edhe ka rrëshqitje të dheut, është kompetencë e Mnistrisë. Ne si Kuvend Komunal kemi debatue, edhe si Bord i Drejtorëve kemi kërkue nga Ministria, dhe na është thënë që këtë vit ka mjete të parashikuara nga Ministria e Infrastrukturës që të rregullohet aksi rrugor Dragash-Restelicë. Kështu që, më duket më shumë se 1 milion euro janë të ndara, nuk kemi nevojë me bo na komision, se ne nuk jemi ekspertë, veç me shkue me u lodhë, me humb kohë, edhe në fund prapë rezultati është zero. Sa i përket pikës eventuale, unë jam i mendimit që – arsyetimet që i dha kryesuesja janë me vend. Pikat e rendit të ditës ju e dini që me ligj i bën kryesuesja me kryetarin. Por, unë jam për, që të futet në rend të ditës pika e ndryshme, mirëpo i kisha lut delegatët

që nëse bëjnë pyetje, të qëndrojnë deri në fund, t'i dëgjojnë edhe përgjigjet. Sepse, faktikisht, nuk po bëhen vetëm pyetje, po bëhen edhe konstatime, po bëhen edhe propaganda, edhe tash njerëzit përmes televizioneve po i dëgjojnë ato, edhe nuk po mujn me e ditë realitetin. Kështu që, le të futet në rend të ditës – i kisha lut delegatët ta votojnë, të futet, të diskutohet, por i kisha lut delegatët edhe që të rrijnë në seancë dhe t'i dëgjojnë edhe përgjigjet e ekzekutivit. Faleminderit!

**Arijetar Skeraj:** Faleminderit! Sejdilar, kërkesa e parë, siç e tha edhe kryetari, është e jashtëligjshme, po që duash, ne e qesim edhe në votim.

**Nedžmidin Sejdilar:** I nderuar kryetar, në vitin 2018, falë votave të partisë suaj dhe të asamblistëve tuaj, është miratuar vendimi që të mos lejohet më ndërtimi i mini-hidrocentraleve në territorin e Komunës së Dragashit. Unë kërkoj që sot Kuvendi Komunal të marrë të njëjtin vendim dhe të mos jepet pëlqimi për ndërtimin e shkrirores në territorin e komunës sonë.

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit! Atëherë, e hedhim në votim propozimin e parë të Sejdilarit, për refuzimin e kërkesave të investitorëve (për kromin). Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 9 vota pro, 12 kundër dhe zero abstenim, nuk kalon kërkesa. Kërkesa e dytë e jotja ishte që të formohet një komision për veturat e QKMF-së më të reja se tri vite. Kush është pro formimit të komisionit? A ka kundër? Abstenim? Me 19 vota pro, 1 kundër dhe zero abstenim, kjo kërkesë futet në rendin e ditës, si pika e pestë. Te kërkesa e tretë, Sejdilar, siç e dish, nuk është kompetencë e Kuvedit që të dalim ne në terren me i kqyr punimet. Atëherë, kush është pro kërkesës së Shpetim Hajredinit që pika eventuale të futet në rendin e ditës? Dua të theksoj se Shpetimi kërkoi që pika eventuale të jetë deri në fund të mandatit. A ka kundër? Abstenim? Me 20 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, edhe pika eventuale futet në rend të ditës, si pikë e gjashtë. Kërkesa e Dritonit ishte që nëse futet pika eventuale, aty ka me diskutue rreth Agjencionit. Atëherë, të nderuar delegatë, me këto dy pika shtesë që u futën tash, kush është pro këtij rendi të ditës? A ka kundër? Abstenim? Me 21 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë rendin e ditës. Atëherë, fillojmë me pikën e parë: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 20 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë pikën e parë. Vazhdojmë me pikën e dytë: Raporti për Realizimin e Buxhetit për periudhën Janar-Mars 2025.

**Driton Ademi:** Atëherë, te Mallrat dhe Shërbimet – nëse është drejtori këtu, shërbimet e udhëtimit në vend, drejtor, unë po e shoh që vjet për vjet në tremujorin e parë po ke rritje. Tip o thuesh i kemi bo investimet 98% , shpeshherë ke dalë edhe ke thënë që po i pagujmë që kanë mbet në

tremujorin e parë. E di çka janë këto, por është mirë pse gjithmonë këtë pyetje je t'u e bo. Shpenzimet e internetit, po më vjen se shumë janë duke u rrit, vjeta e vjetës. Te pjesa e shërbimeve këshilldhënëse dhe profesionale – 6 mijë euro – asnjë vjet s'po e shoh çka keni pague këtu, a ka mundësi me e ditë? Te pjesa e shërbimeve kontraktuese, vitin e kaluar keni pas 258 euro, këtë vit 48 mijë euro janë. Pajisje sportive – 1300 euro; karburantet për automjete – 9 mijë në 2023'tën, 14 mijë në 2024'tën, 24 mijë në 2025'tën, në tremujorin e parë. Rritje enorme, që ke 170% ke rritje. Edhe te mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve – 9 mijë euro. A ka mundësi për këto një përgjigje, drejtor, me e ditë se çka është kjo rritja e këtyre pagesave në tremujorin e parë. Faleminderit!

**Shpetim Hajredini:** I nderuar drejtor, do të jem shumë i shkurtër. Vetëm nja dy pyetje në shpejtësi deshta të t'i bëj. Tek Subvencionet dhe Transferet, kolonat në të cilat i ke parapa edhe kodet, edhe pagesat, vitet nuk i ke shënuar, po besoj që ka të bëjë me vite. Ke harrue t'i ndajsh me vite, sepse subvencionet – për shembull, pagesat për përfituesit individualë është 5920, i përket këtij viti 2025, ndërsa dy kolonat tjera janë për 2024 dhe 2023, nëse nuk jam gabim. A është kështu e parashikuar në kolona? Ma japish përgjigjen. Edhe tek Fondi 10 99 i buxhetit, të gjitha këto projekte për të cilat e ke bo pagesën, a janë projekte të vitit të kaluar, të përfundime këtë vit dhe e ke bo pagesën, apo janë këto projekte të cilat kanë përfundue këtë vit dhe këtë vit e ke bo pagesën? Nëse ka mundësi vetëm me më dhënë sqarim për këto dy pyetje? Ju falimderit!

**Munir Jonuzi:** Përshëndetje të gjithëve. Më intereson çfarë është kjo donacion simbolik nga Ambasada e Bullgarisë prej 1 euro. Ambasada Sllovaqe çdo vit na dhuron të njëjtën shumë të mjeteve, pak më pak se 3,000 euro, më intereson për çfarë përdoren këto mjete. E dimë që janë të destinuara për Drejtoratin e Urbanizmit dhe Kadastrës, por konkretisht më intereson për cilat projekte. Sa i përket ambasadës japoneze, më intereson sa ka dhuruar kjo ambasadë për komunën tonë. Ata kanë paraparë rreth 55,000 euro, më intereson sa kemi shfrytëzuar prej tyre. Pyetja e katërt: Në buxhetin për vitin 2025 nga Granti i Performancës janë ndarë 45.22 euro – çfarë është kjo dhe për çka janë ndarë? Pyetja e pestë: Nga të hyrat e donatorëve që përbëjnë gjithsej 0.36% të buxhetit – a është ndonjë gabim apo është vërtet ky përqindja nga donatorët? Sa i përket pagave dhe shtesave, kam informatë që aktualisht nuk paguhen orët e kujdestarisë për punëtorët shëndetësorë – më intereson arsyeja. Kemi shpenzime të udhëtimeve, nën kodin 13010, shpenzime që po rriten në mënyrë konstante. Nëse i krahasojmë me vitin 2023 është shumë më shumë, ndërsa me vitin 2022 kemi një rritje 12 fish më të madhe. Është një rritje enorme e

shpenzimeve të udhëtimit brenda vendit. Më intereson cili është arsyeja për këto shpenzime. Kodi 13460 – për cilat shërbime konkrete bëhet fjalë kur janë shpenzuar 48,000 euro? Kodi 13630 – shkruan Furnizim mjekësor dhe aty janë ndarë 31,000 euro – kam parë tenderët dhe kam parë që është shpallur vetëm një tender për furnizim me barna rreth 13,000 euro – më intereson për çfarë bëhet fjalë. Kodi 1370 – Karburant për automjete. Deri tani gjithmonë kam pasur mirëkuptim për këtë kategori sepse komuna shpenzonte për transportin e nxënësve dhe kjo ishte një praktikë e mirë, prandaj gjithmonë kemi pasur shpenzime shtesë për karburant. Nëse e krahasojmë me vitin e kaluar kemi rritje rreth 10,000 euro. Si komunë nuk e bëjmë më transportin e nxënësve sepse vitin e kaluar kemi shpallur tenderë dhe tani janë të angazhuara kompani private. Më intereson pse kjo rritje? Kam informatë që Passat-i i përmendur në seancën e kaluar me targa 387 po përdoret për qëllime private dhe për shpërndarje të gjithçkaje. Pasi e kam përmendur shumë herë këtë targë, tash njerëzit po e ndjekin këtë automjet dhe kemi keqpërdorim të tij. Kodi 14010 – Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve – më intereson për cilat automjete janë shpenzuar këto mjete dhe pse është shpenzuar shuma prej 9,000 euro për mirëmbajtje. Dhe një gjë e mirë – rritja e shpenzimeve për rrymë është plotësisht e arsyetuar sepse keni nisur një praktikë të mirë dhe ju përgëzoj nga ana ime. Shpresoj që kjo praktikë të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme – mirëmbajtja e ndriçimit publik në fshatrat e komunës sonë. Dua t'ju falënderoj në emër të këshillit të fshatit Rapçë që dje menjëherë pas diskutimit tonë keni reaguar dhe keni detyruar zyrtarin që ta kryejë punën. Sa i përket mirëmbajtjes së ndriçimit publik – gjithmonë përdorni autoritetin tuaj kur janë në pyetje zyrtarët e kësaj komune, veçanërisht ata të kadastrës dhe urbanizmit, sepse gjithmonë përpiqen në çdo mënyrë që t'i shtyjnë obligimet e tyre.

**Artan Loshaj:** Shumicën e pyetjeve i kanë bo, unë shumë shkurt me kryetarin. U tha edhe ma herët nga Dritoni, tek Mallrat dhe Shërbimet - kodi 13130 – në vitin 2023 kanë qenë 8 mijë euro, në vitin 2024 38 mijë, ndërsa tash 51 mijë. Çka është duke ndodhur? Po shkojmë te 13780 – karburantet për automjete – e thanë edhe kolegët, Munir, si shok po të them se sivjet ka qenë vit zgjedhor, edhe ke harrue që veturat ma shumë janë përdorë për fushatë. Sidomos nga CDU-ja, nga Uzairi edhe mësuesi drejtor. Që e ka edhe veturën zyrtare që e merr ai, e përdorën si pronë private të veten. Kjo është një keqpërdorim edhe kërkoj nga kryetari që të fillojë me marrë masa. Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve është e njëjtë, se këta edhe i kanë fry pak faturat, është dashtë me u prish pak nëpër fshatra, 24 orë kanë ec. Bile qysh kanë ec këta kerrat, po më vjen

shumë e vogël 9 mijë euro, s'është kurgjo kjo. Pre 1300 në 2023-tën, 164 në 2024-tën, 9 mijë euro në 2025-tën. Unë edhe qetu nuk e pata të kuartë, 31510 – pajisjet e gjenerimit të energjisë elektrike, 177 mijë euro. Nuk e kam të kuartë, që ka mundësi drejtori me na spjegue. Edhe në fund, te tatimi, të hyrat vetanake, në vitin 2023 drejtori ka akumuluar 48 mijë, në 2024-tën 38 mijë, tash në vitin 2025, janë 26 mijë. Është për çudi, të nderuar kolegë edhe qytetarë, se kur është puna e harxhimeve, këta harxhojnë shumë, ndërsa kur është puna me e mbledhë tatimin, tatimi çdo vit zvogëlohet. Drejtori bashkë me kryetarin e ka akuzue PDK-në se s'po di me mbledhë të hyra. Por, këta na kanë kalue edhe neve, janë bo smart drejtorë. Faleminderit!

**Qamil Kolloni:** Përshëndetje kryetar, përshëndetje kryesuese, delegatë, ju media dhe të gjithë të pranishëm! Unë po mundohem të mos ju seleksionoj si individë, për afërsisht ju të gjithë i keni të njëjta pyetjet. Një herë ta bëjmë sqarimin logjik të këtij raporti, dhe pastaj do ta shihni veten secili se a do të merrni përgjigje në atë aspekt të cilin keni kërkuar. Sa i përket Munirit, për formimin e buxhetit, 1 euro të Ambasadës Bullgare, janë mjete të cilat kjo ambasadë i ka dhënë donacion dhe sistemi i parasheh që kemi mbet 1 euro pa shpenzue, dhe detyrimisht jemi detyruar t'i alokojmë për vitin 2025 dhe t'i bartim ato. Gjithashtu kemi pas edhe me Ambasadën Japoneze dhe i kemi bart për vitin 2025 të gjitha këto donacione dhe krijue buxheti me vlerë 12,872,214 euro, duke i pas parasysh edhe të hyrat vetanake të cilat i kemi të parapame për me i grumbullue gjatë këtij viti, që vlera e përgjithshme e këtij viti është 12,918,315.18 euro. Mendoj se i ke të qartë se si është formuar ky buxhet. Sa u përket shpenzimeve të Subvencionet dhe Transferet, janë disa subvencione të cilat i kemi ndarë për bujqësi dhe i ka marrë përmbaruesi, jemi detyruar që këtë vit të bëjmë pagesat e tyre nga mjetet tona vetanake, për arsye se nuk kemi pas që t'i kryejmë vitin e kaluar ato subvencione. Pse janë rritur shumat të udhëtimit në vend? Ju e dini që i transportojmë nxënësit. Dhe, ndonjëherë bëjmë pagesë më shumë, ndonjëherë bëjmë pagesë ma pak. Mirëpo, vitin e kaluar nuk kemi mundur t'i bëjmë pagesat e përgjithshme, se edhe aty janë marrë nga mallrat dhe shërbimet, nga përmbaruesi, dhe ka mbet pjesa që gjatë këtij viti i kemi krye edhe obligimet e vitit të kaluar, edhe të këtij viti, dhe reflekton si një shumë pak më e madhe në tremujorin e parë, që do të thotë se tremujorët tjerë mund të paguajmë më pak. Te Shërbimet Kontraktuale, ju e dini se kemi një marrëveshje tash edhe për varrezat, dhe në këtë pozicion e bëjmë pagesën, dhe detyrimisht kjo mund të ndryshojë varësisht prej vdekjeve. Te automjetet dhe riparimi i tyre: Duhet ta dini se në kuadër të riparimit të automjeteve, këtë vit kemi bo edhe riparimin e traktorëve që gjatë dimrit, ju e dini që ky dimri ka qenë pak më i egër, kemi pas disa

dëmtime dhe kemi bo riparimin e traktorit, dhe janë reflektue këtu si riparim i automjeteve. Gjithashtu, edhe shpenzimet për karburante janë shtuar, për faktin se nga ky pozicion paguajmë edhe karburantet për traktor dhe këtë dimër i kemi pas më aktiv edhe në mënyrë normale që kanë reflektue këto si shpenzime. Sa u përket pajisjeve specialistike mjekësore – 96 euro – me ju thënë të drejtën, sinqerisht nuk e di çka është paraprë, po ashtu shkruan në faturë dhe këtu në buxhet është reflektuar. Nuk e di çka është diçka speciale, por mund ta pyesim drejtorin, është një vlerë shumë e vogël, 96 euro, nuk reflekton diçka në buxhet. Është pozicion në buxhet, por mund edhe mos të jetë speciale ai mjeti. Por, në aspektin buxhetor, 96 euro nuk reflekton ndonjë shpenzim ekstra të veçantë. Në përgjithësi, unë mendoj se të gjitha këto shpenzimet janë faktike. Edhe ne kemi biseduar në vazhdimësi edhe për të hyrat, edhe për rënien e të hyrave. Është mirë kur po e bëni pyetjen, por po më vjen keq kur po i jepni kualifikim politik. Me qeto vendime që i ka marrë qe ky Kuvendi, ne jemi duke i ekzekutuar. Ju duhet ta dini një fakt shumë të arsyeshëm. Ne kemi gjet 2 milionë e 900 mijë euro borxh të grumbulluar, dhe tash e kemi borxhin 1,650,000. Me nënshkrimin e kontratave, kemi pas të hyra të shtuara, mirëpo reflektojnë për arsye se ne kemi zbrit borxhet. Përpos kësaj, ne kemi ulë edhe tatimin në pronë, gjithashtu edhe ligji për këtë vit e ulë, sepse nga 15 mijë euro të cilat i ka pague qeveria, tash paguan 30 mijë euro dhe kjo në mënyrë automatike është reflektue në buxhet. Gjithashtu, me vendim të Kuvendit ne kemi ulë edhe përqindjen e tatimit në pronë, kemi ulë edhe bazën nominale, dhe tatimi në pronë është ulë. Mirëpo, në përgjithësi, kemi një rritje të buxhetit, dhe i kemi kalue të gjitha edhe këtë vit, 57 mijë euro para kësaj seance kemi bo ndarjen apo bartjen e mjeteve të të hyrave vetanake të cilat i kemi pas shtesë. 57 mijë euro kemi grumbulluar më shumë se që është paraparë. Pra, me të gjitha lehtësirat që iu kemi bërë qytetarëve, drejtpërdrejt edhe bizneseve, ne kemi arrit përsëri ta kalojmë planin e paraparë për grumbullimin e të hyrave. Dhe kjo duhet të çmohet, nuk duhet të kritikohet, por nëse i marrim duke i krahasuar gjërat, ju duhet ta dini se pikërisht për shkak të borxhit të grumbulluar dhe që nuk keni vepruar, në të shumtën e rasteve nuk keni qenë pjesë edhe e Grantit të Performancës. Prandaj, unë pa dashtë me bo politikë, dashta me ju sqarue se këtu kemi qenë bashkërisht në këto vendime të cilat i kemi marrë dhe kemi bërë zbritjen e tatimit për qytetarët, me këtë Kuvend. Kur doni me e shfrytëzue politikisht mikrofonin, është çështje tjetër. Kur doni profesionalisht, vendimet i kemi marrë bashkërisht.

**Bexhet Xheladini:** E falënderoj drejtorin Qamil për dhënien e informatave, unë vetëm dua ta plotësoj. U përmendën pajisje speciale, është fjala për 96 euro, janë pajisje të cilat janë blerë për

stomatologji. Gjithashtu, këtu u fol edhe për shpenzimet e karburanteve. Siç e dini, siç tha edhe drejtori, nga muaji dhjetor deri në muajin prill kemi pas një dimër shumë të ashpër, ku traktorët kanë qenë vazhdimisht në aksion, normal që kanë bërë edhe shpenzime të karburanteve. Gjithashtu, me një vendim timin, një person privat nga fshati Radeshë, një nga fshati Orqushë dhe një nga fshati Buqe, ata kanë marrë karburante për hapjen e rrugëve nga bora, për arsye se ne si Kuvend Komunal nuk kemi mujt me i mbërri hapjen e rrugëve nga bora. U fol edhe se janë keqpërdor automjetet gjatë fushatës elektorale, që nuk është e vërtetë. U përmend edhe emri i Uzairit. Unë dua të them se Uzairi është personi i cili asnjëherë nuk e ka përdor dhe nuk e përdor automjetin e vet për nevoja personale. Siç e dini, Uzairi e bën edhe transportin e nxënësve në dy drejtime, i mer nxënësit e fshatit Kërstec edhe i çon në shkollën e fshatit Rapçë. Gjithashtu, sa u përket shpenzimeve të karburanteve, derisa në pjesën e Opojës bëjmë transportin me një kompani të kontraktuar, në pjesën e regjionit të Gorës kemi person i cili bën bartjen e nxënësve, por që me vendim të kryetarit, ne pagesën atij ia bëjmë me furnizim me karburante. Kështu që, të gjitha këto kanë ndikuar që të dalë shifra më e madhe në krahasim me tremujorin e kaluar, sa u përket shpenzimeve të karburanteve. Gjithashtu, u përmend se për mirëmbajtje, në krahasim me tremujorin e vitit të kaluar, kemi një shumë më të madhe. Dua të ju njoftoj se vitin e kaluar, Komuna gati një vit ka qenë pa kompani kontraktuese për mirëmbajtjen e automjeteve, edhe tremujorin e vitit të kaluar, nëse bëjmë krahasimin, kemi shifrën diku 100-150 euro shpenzime. Kështu që, siç e dini, ky dimër që e kaluam ka qenë më i ashpër se vitet e kaluara, për atë edhe ka pas nevojë edhe të bëhen riparime të traktorëve. Gjithashtu, pjesa më e madhe e mjeteve që janë shpenzuar për riparimin e automjeteve është nga QKMF. Siç e dini, për çdo ditë po vijnë duke na u shtuar edhe pacientët e dializës, tash kemi nevojë deri në tre automjete me i angazhë për bartjen e personave me dializë. Drejtori Qamil i përmendi mbetjet nga ambasadat bullgare, sllovaqe dhe japoneze, janë mbetje të cilat nuk janë shpenzue. Të Ambasadës Bullgare kanë mbet 1 euro, të Ambasadës Sllovaqe diku 3 mijë euro, dhe Ambasada Japoneze e cila ka bo financimin e një ndërtimi të objektit për grumbullimin e mbeturinave në hyrje të Restelicës, Ambasada Japoneze ka ndarë diku mbi 70 mijë euro, kontrata ka qenë e lidhur në këtë formë. Mirëpo, kur është shpallë tenderi, faktikisht një kompani ka hy shumë lirë. Kështu që, mjetet që kanë mbet ne jemi detyruar me i bart nga viti i kaluar në këtë vit. U përmendën diku 45 euro të Grantit të Performancës, këto janë mjete të cilat kanë mbet, nuk janë harxhuar, sepse në bazë të tenderit nuk kanë mujt të harxhohen dhe ato mjete janë bart nga viti i kaluar në këtë vit. Për shpenzimet e udhëtimit në vend,

ju e dini që ne qe dy vjet e bëjmë transportin e nxënësve, edhe këto shpenzime hyjnë në këtë kategori. Shpenzimet kontraktuale, i tha edhe Qamili, janë shpenziem të varrimit. Sa i përket uljes së inkasimit të tatimit në pronë, ju e dini që Asambleja Komunale ka prurë vendim për uljen e tarifave. Gjithashtu është edhe një problem tjetër, ju të gjithë jeni dëshmitarë që para 10-15 ditëve, të gjithë ne kemi marrë faturat e tatimit në pronë nga posta. Kështu që, ka pas një vonesë për tre muaj. Sa i përket shpërndarjes së faturave të tatimit në pronë, tash a është problemi te Ministria e Financave e cila nuk i ka bo shtypjen e këtyre faturave, a është problemi te posta e cila nuk e ka bërë shpërndarjen – këtë do ta shohim ditët në vijim, do ta sqarojmë edhe këtë problem. Faleminderit!

**Driton Ademi:** Drejtor, edhe pse ta boni këtë pyetjen Artani, po mu po më intereson. Pajisjet e gjenerimit në energji elektrike. A ka mundësi, nuk dhaje një sqarim, kush hyn te qeto pajisjet? Se ti edhe te investimet, te Fondi 10, e dhaje në mënyrë të përgjithshme. E kuptuam që janë edhe borxhet e vitit të kaluar, që i keni pague tash. Po te qekjo “Pajisjet e gjenerimit të energjisë elektrike”, a ka mundësi me e ditë kush hyn te qeto pajisjet? 177 mijë euro janë pagesa. Nëse ka mundësi një përgjigje.

**Munir Jonuzi:** Mësuam se nga vijnë ato 1 dhe ato 3.000 euro. Mendoj që duhet të formuloni ndryshe fjalitë në tekst, që të kuptohet se këto mjete kalojnë nga buxheti i vitit 2024 në buxhetin e vitit 2025. Ajo që mbetet për të ardhur keq është pse mjetet e tjera nga Ambasada Japoneze nuk janë shfrytëzuar tërësisht. Ajo që nuk më keni dhënë përgjigje është: a u paguhen kujdestaritë punëtorëve shëndetësorë? Këtë e keni harruar. Sa i përket furnizimit mjekësor, z. drejtor, shikoni kodin 13630 – nuk janë në pyetje 90.000 euro, por 31.000 euro. Sa i përket furnizimit mjekësor, bazuar në analizën e kontratës që ju e keni nënshkruar dhe në bazë të tenderit që e keni shpallur, ishte paraparë shuma prej 13.000 euro. Ai tender është shpallur në muajin mars dhe është dashur të përfundojë më 10 prill. Kam marrë informacion se punëtorët shëndetësorë i kanë marrë barnat. Mua më intereson pse janë 31.000 euro nëse tenderi i shpallur ishte për 13.000 euro. Mund t’jua tregoj menjëherë atë kontratë – nuk po flas pa fakte. Sa i përket mirëmbajtjes së automjeteve – për cilat automjete bëhet fjalë? Vitin e kaluar kemi nënshkruar tender dyvjeçar, diku rreth 35.000 euro për mirëmbajtje dhe servis të automjeteve të komunës. Më intereson pse tani janë edhe 9.000 euro shtesë?

**Bexhet Xheladini:** Muajin e kaluar, për shkak të mungesës së buxhetit – nuk na ka ndodhë vetëm neve, por shumë komunave – nuk është pague. Mirëpo, kujdestaritë paguhen, edhe janë duke u

paguar, edhe ka mjete për pagesën e kujdestarisë. Sa u përket pajisjeve të gjenerimit të energjisë elektrike, është memorandum që e ka nënshkruar kryetari i Komunës me KESCO-n, për ndërtimin e rrjetit të tensionit të lartë të linjës së Restelicës. Është bërë pagesa, kjo është ajo shuma që është bërë. Janë mjete të cilat kanë qenë të parapara për bashkëfinancim me donatorë. Edhe janë mjete të cilat kanë qenë të dedikuara për komunitetin joshumicë. Sa i përket shumës që e përmendi zv.kryesuesi, për pajisje dhe barna, unë do të mundohem këto përgjigje t'ia jap në pikën eventuale. Do të marr tash informata në Zyrën e Prokurimit, edhe do të jap informata të sakta në pikën eventuale. Faleminderit!

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, kush është pro Raportit për realizimin e buxhetit për periudhën Janar-Mars 2025? A ka kundër? Abstenim? Me 18 vota pro, zero kundër dhe 1 abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë te pika e tretë: Anulimi i Vendimit për financimin e shujtave ditore për nëpunësit e shërbimit civil të Administratës së Komunës së Dragashit 01 Nr.060.01-7/25 të datës 28.02.2025. A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike?

**Shpetim Hajredini:** Edhe në seancëne e dytë – nëse nuk gabo – kur ka ardhë ky propozim që ne ta votojmë dhe ta mbështesim, kam thënë se nuk ka bazë ligjore. Edhe problemim tjetër të cilin e kishin evidentue tash edhe Ministria, që nuk ka planifikim buxhetor, edhe këtë e kam ditë se kanë me e kthye prapë pikërisht edhe për këtë çështje. Ky Vendim doli i paligjshëm për shkak të neglizhencës, për shkak të – s'po them – paaftësisë, por dëshirës që të mos lexoni edhe të mos i pranoni këto që ne po ua sugjerojmë juve. Me kokëfortësi po i merrni vendimet, veç se po i keni votat, edhe tash po na i kthejnë prapë. Natyrisht që ne jemi pro, kemi qenë pro, edhe atë ditë, edhe pse e kemi ditë që do të ktheht prapë, por kemi qenë pro, për arsye se kanë bërë një kërkesë punëtorët e kësaj Komune, të Administratës. Edhe sot, prapë unë jam pro kërkesës së tyre, nuk jam që të kthehet ky vendim prapë. Unë jam që t'i mbështesim këta punëtorë. Formën, mënyrën se si do të paguhen këta punëtorë, e ka përgjegjësinë drejtori i Financave. Edhe unë jam i bindur që deri në përfundim të këtij viti ka mundësi buxhetore që të bëjë rialokim të mjeteve dhe ta përfundojë këtë kërkesë të këtyre punëtorëve të Komunës të cilët e kanë kërkuar dhe kjo pikë në të cilën është bazuar Ministria edhe na ka kundërshtue, ne ta kemi në rregull dhe të mos kenë ata hapësirë që të na kthejnë prapë edhe një herë këtë vendim. Prandaj, unë personalisht, po besoj që do ta kem edhe mbështetjen e grupit, këtë propozim-vendim të kryetarit për anulimin e atij Vendimit i cili është

marrë në shkurt, unë nuk e mbështes, por shpresoj që do ta kem edhe mbështetjen e grupit dhe të gjithë juve. Faleminderit!

Propozimi im konkret është që të bëhet rialokimi i mjeteve dhe deri në fund të këtij viti të ketë mundësi Drejtorja e Financave që ta bëjë një drejtim, një ndarje të buxhetit, ku e sheh të arsyeshme drejtori i Financave, tek kjo pikë në të cilën është referuar Ministria. Propozim për rishqyrtim, thashë edhe më herët.

**Bexhet Xheladini:** Propozimi i Shpetim Hajredinit është shumë kontradiktor. Në fillim të diskutimit tha që ju kemi thënë juve që mos të bini këso vendime se janë të kundërligjshme, tash propozon prapë një propozim të kundërligjshëm. Vendimet të cilat vijnë të kundërligjshme, Asambleja Komunale është e obliguar me ligj me i anulue. Edhe rialokimin e mjeteve ti e dish që ligji nuk ta lejon, se nuk ka rishikim të buxhetit. Qe tri ose katër vjet nuk ka pas rishikim të buxhetit. Ne çka mujm me bo, tash kur të përgatitet buxheti i vitit 2026, Asambleja mund të propozojë mjete për vitin 2026, edhe pastaj, nëse Ministria na lejon, ne mund ta bëjmë pagesën e shujtave. Është në dorën tuaj, këtë vit, kur a përgatitni buxhetin, me nda mjete për shujta. Përndryshe, unë si kryetar i Komunës jam i obliguar që t'u sugjeroj asambleistëve që vendimet të cilat vijnë dhe thuhet që janë të kundërligjshme, ne duhet me i shfuqizue. Unë thashë, e vetmja mënyrë është me nda ne mjete këtë vit, kur ta përgatitim buxhetin për vitin e ardhshëm. Përndryshe, rishikim të buxhetit nuk ka. Rialokime nuk bëhen, nuk ka mundësi. Po edhe me pas mundësi, duhet me pas ku me i marrë, për me i qit, se diku janë afër 300 mijë euro. Kështu që, është më mirë me i planifikue në buxhet të vitit 2026 dhe pastaj me fillue me e bo pagesën.

**Shpetim Hajredini:** Atë që e potencova në fillim, ka të bëjë me seancën e kaluar. Të thashë, të kam thënë qeshtu, ju nuk e keni marrë parasysh, ndërsa tash po të them qeshtu: keni mundësi deri në fund të vitit, në fund të vitit – ti s'ke njohuri në atë drejtim, se normal, je doktor edhe nuk ke lexue shumë në financa, nuk mundesh me e ditë, por drejtori i Financave e di që në fund të vitit ka të drejtë, nëse ndodh, për shembull – po ta them tash, edhe pse nuk e pata ndërmend me ta tregue – nëse ndodh që një projekt e sheh ti që nuk është ...po ta tregoj sinqerisht, ke mundësi me e bo bartjen e mjeteve prej atij projekti i cili nuk mund të realizohet. Edhe Ministria mund me ta marrë të arsyeshme, munden edhe mos me ta marrë, mirëpo ke mundësi me e përdor këtë metodë. Ndërsa tjetra, që e dhaje ti opsionin e dytë, ai është opsioni tjetër të cilin Ministria nuk ka formë, mënyrë, që mund të na kundërshtojë. Atë mujm me e marrë për vitin 2026, edhe me e krye atëherë.

**Artan Loshaj:** Kryetar, në fillim shkove keq, po në fund e përmirësove. Unë në seancën kur e keni prur në rend dite, si Shpetimi – se nuk jam as ekonomist, e as jurist – ju kam thënë që kjo është e paligjshme. Ju kam kërkue që në vitin 2026 – e keni edhe procesin – që në vitin 2026 të ndajmë mjete për këto, plus të kam kërkue në Komitet me nda mjete, afër 90 mijë euro për shujtat e QKMF-së, që 22 muaj nuk i kanë marrë. Ju e keni qit në rend të ditës, vendimin e keni marrë negativ prej Ministrisë, për atë jeni kampionë se non stop dështoni. I keni edhe nenet – thashë mos t’i dal juristit përpara – e keni Nenin 17 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, edhe Nenin 38. Këtu shkruan shumë mirë që në fillim duhet me nda mjete, masnej me bo kërkesë. Kërkesa ime ka qenë dhe është: në buxhetin e vitit 2026, në shtator kur të miratohet, të ndajmë – shumë unë sa e kam bo llogari është afër 380 mijë euro për punëtorët e Komunës dhe afër 90 mijë euro janë për punëtorët e QKMF-së – afër 470 mijë euro të ndajmë në vitin 2026, që t’i alokojmë këto mjete për me i bo pagesat e shujtave të QKMF-së dhe punëtorëve të Komunës.

**Samidin Xheladini:** Të nderuar të pranishëm, ju përshëndes të gjithëve! Po më bën përshtrypje, ne duhet ta dimë çka kemi folë edhe për çka kemi folë. Po më vjen se nuk janë qata njerëz të njëjtë të cilët kanë folë në seancën kur ka qenë në rend të ditës për këto mjete, po më vjen se qata persona kanë ndërrue krejtësisht. Le të marrin ta shohin seancën, çka kanë folë në atë seancë edhe çka kanë folë sot. Nuk bën kështu, me dy fytyra nuk bën. Ne jemi këtu me dhënë kontribut, për me zgjidhe çështje edhe probleme. Ne jemi deklarue të gjithë atë ditë që me e dhënë kontributin maksimal edhe kjo çështje me kalue. Të gjithë kemi qenë të vullnetit të mirë, që me e dhënë kontributin sa të kemi mundësi, në mënyrë që me e kalue edhe kjo çështje me e marrë drejtimin e duhur. Në atë kontekst na u servue edhe një çështje tjetër, që edhe kryesuesja, edhe kryetari edhe të gjithë të pranishmit, kemi thënë që në mbledhjen e radhës. Na u kthye vendimi joligjor. Kanë bo propagandë qata personat e njëjtë, asambleista, që unë dhe disa kolegë të mi këtu, të Asamblesë, që janë prezentë, se na nuk e kemi votue që të futet në rendin e ditës propozimi për QKMF-në. Edhe kemi qenë shumë të sinqertë, edhe kemi tregue arsyet pse nuk do të futet atë ditë, por një mbledhje të radhës të gjithë kemi qenë të gatshëm me e fut. Dhe kanë bo propaganda të tmerrshme se ne nuk jemi për punëtorët, për kolegët atje. Nuk bën kështu, duhet të jemi të sinqertë, për hir të së vërtetës dhe realitetit duhet të jemi të sinqertë, mos t’i manipulojmë njerëzit edhe me i nxit, që ne s’qenkemi për QKMF-në ose për ata qenkna, e për këta s’qenkna, diçka të ngjashme kështu, propaganda. Edhe aty s’e kanë përcjellë mbledhjen si ka qenë, se s’ka qenë në rend të ditës fare. Nuk ka qenë në rend të ditës fare çështja e QKMF-së, nuk u fut në rend të ditës edhe nuk u debatua

fare. Edhe kanë thënë me emra e mbiemra, se filani e fisteku kanë votue kundër për mos me iu nda mjete. Duhet me qenë të sinqertë edhe me e ditë çka duhet me synue. Në kontekst të kësaj po biem ndesh me vetveten. Në qoftë se ne duhet me marrë obligime edhe me ia realizue dikujt, duhet me e ditë edhe paraprakisht qysh me arrit deri te ai qëllim. E jo vetëm me bo fushatë edhe eufori. Faleminderit!

**Agron Gashi:** Më lejoni të ju përshëndes, të pranishëm! Nga kjo foltore, më datën 28.02.2025, ishte çështje diskutimi lidhur me këto shujtat e nëpunësve komunalë, nga kjo foltore ju drejtova se unë isha pro, se vërtet kanë udhëtime, pagat e ulëta, dhe janë të nevojshëm. Mirëpo, duke e parë situatën e përgjithshme, kërkesat e tyre, nga viti 2021, 2022, të bëhet kompenzimi i shujtave të tyre. Tash jemi në vitin 2025, unë atë ditë ju thashë se nuk do të gjejë zbatim praktik për t'u ekzekutuar këto shujta, ngase janë vite që kanë kaluar, janë shuma të konsiderueshme dhe çdo gjë që nuk hyn në planifikim buxhetor është e kundërligjshme dhe dikush duhet të japë llogari për to, por mund të ndiqet edhe penalisht. Çdo gjë që nuk është planifikim buxhetor është vepër penale. Tash, unë sa shoh, ka përplasje më shumë politike. Njëri grup thotë jepja, kur e dimë fort mirë se nuk mund të implementohen këto, ndërsa grupi tjetër s'ka çka të përgjigjet më tej se nuk mund. Derisa MAPL kthen përgjigje që nuk ka bazë ligjore, ne duhet t'i kuptojmë gjërat, që s'ka mundësi. Çdo përplasje tjetër është për qëllime politike të cilat vetëm se humbim kohë, por një fjalë e Shpetim Hajredinit më pëlqeu, që neve duhet të planifikojmë tash e këtej. Nëse hyjmë në kuadër të planifikimit buxhetor, të cilët nga 2025/26 për të ekzekutuar këto shuma për shujta. Atëherë gjithaçka është e arsyeshme. Për kohën e cila ka kaluar i përket të kaluarës dhe nuk ka mundësi që të implementohet kjo. Kështu që, marrë parasysh një Komunë të dobët në kuptimin financiar, me mjete të dobëta, me një buxhet ku 4.5 milionë euro për 35 fshatra në investime kapitale, vërtet nuk ka mjete të mjaftueshme për këtë. T'i dallojmë Prishtinën e Prizrenin, ku kanë rreth të gjerë dhe kanë mjete financiare të cilat ndoshta komuna mund t'i marrë mbi supet e veta. Po kjo Komunë, me këtë gjendje, me këtë buxhet aktual që e ka, t' ndajmë mjetet nga investimet kapitale dhe t'i gjujmë për këto, është një llogaridhënie, përgjegjësi ligjore. Faleminderit!

**Bexhet Xheladini:** Po më vjen keq që disa persona këtu – si tha edhe parafolësi, që para një muaji kanë folë ndryshe, sot folin ndryshe. Nuk është mirë që këta njerëz të mbajnë në shpresa të rrejshme punëtorët e Komunës, që gjoja se këta janë pro edhe janë për me i marrë, faktikisht ata vetëm po i mbajnë në shpresa të rrejshme për një gjë që nuk mundet me u realizue. Unë nuk jam kundër që punëtorët e Komunës t'i marrin këto shtesa, por a ka mundësi me u bo? Nuk ka mundësi

me u bo, nëse nuk ke pare, nëse nuk ke mjete të planifikume. Ka mundësi vetëm nëse jus i Asamble parashihni për vitin e ardhshëm mjete, edhe i futni në buxhet si kategori e veçantë për pagesat. Nuk ka mundësi ligjore që mjetet e investimeve kapitale – nuk është mirë këtu me dalë edhe me i gënjye njerëzit – mjetet e investimeve kapitale nuk e lejon ligji me i bart, e me i pague shujtat. Absolutisht është kundërligjore. Edhe nuk ka rishikim të buxhetit. Nëse do të ketë rishikim të buxhetit, nëse Qeveria ua jep të drejtën komunave që ta bëjnë rishikimin e buxhetit, atëherë ne si Asamble mblidhemi, edhe vendosni, është në dorën tuaj, i gjeni parat, i merrni prej diku tjetër, i qitni në këtë kod për pagesën e shujtave edhe kjo punë kryhet. Mirëpo, nëse nuk anulohen vendimet që Ministria i kthen si të paligjshme, kryetari edhe kryesuesi mund të shkojnë lirisht në gjykatë. Kemi pas një rast, ku kryetari para meje që ka qenë – e di edhe Ademi – lënda ka qenë në gjykatë, po fati që ankesës i ka kalue afati edhe këta nuk janë dënuar. Përndryshe, do të ishin dënuar. Kështu që, vendimet që i bjer Ministria, duhet ne me i anulue, por nëse Qeveria bjer një vendim edhe ua lejon komunave rishikimin e buxhetit, atëherë ka mundësi që edhe këtë vit kjo punë të kryhet. Përndryshe, nëse Qeveria nuk bjer vendim dhe nuk i lejon komunat të kenë rishikim të buxhetit, atëherë ju planifikoni për vitin e ardhshëm. Ju kisha lut, mos e përdorni këtë foltore për qëllime politike, e di që zgjedhjet janë afër edhe doni që për përfitime të vogla personale e politike të dezinformoni opinionin dhe njerëzit të cilët kanë nevojë edhe për shujta, sepse edhe pagat i kanë të vogla, po megjithatë, të jeni shumë korrektë, jeni të zgjedhur të popullit dhe duhet të delni në foltore ta thoni të vërtetën, ta thoni atë që është ligjore dhe atë që ka mundësi. E jo me i mbajt njerëzit me shpresa të rrejshme, se ju jeni pro, por kryetari është kundër. Unë e di që qëllimi juaj është që ta qitni kryetarin që nuk e përkrah këtë kërkesë, që është e kundërta. Unë herën e kaluar ju kam thënë me e votue, edhe pse e kemi ditë që nuk është kërkesë ligjore, por me iu tregue qytetarëve, por edhe punëtorëve të Komunës, që kryetari nuk është kundër, është pro, por ja që ka ardhë ky vendim të cilin duhet ta rishqyrtoni ju. Faleminderit!

**Qamil Kolloni:** Të nderuar delegatë, politikisht ne jemi të gjithë të vullnetit që me nda edhe shujta, edhe mëditje. Mirëpo, ju e dini që secila komunë ka edhe një zyrtar nga Ministria e Financave dhe Transfereve, dhe kur fillojmë me e bo ndarjen e buxhetit, është korniza buxhetore e cila nënkupton se janë limitet me të cilat neve ballafaqohemi. Nuk mund t'i rrisësh mallrat dhe shërbimet, pa e pas një arsyeshmëri ligjore. Ti mund t'i rrisësh, po ato t'i kthejnë prapë. Janë kategoritë buxhetore: Invesime Kapitale, Mallra dhe Shërbime, Subvencione dhe Transfere, dhe Shpenzime Komunale. Nga Granti i Përgjithshëm janë të ndara pagat dhe mëditjet. Shujtat edhe këto i marrin ato komuna

të cilat kanë të hyra vetanake, të vetat. Në qoftë se e shohim, 500 mijë euro janë të hyra vetanake të përgjithshme të Komunës së Dragashit. Dhe si e hyrë vetanake, ne edhe subvencionet i kemi rrit për bujqit edhe kemi pas vullnetin dhe kemi shkue me kërkesën që t'i japim. Mirëpo, nga Granti qeveritar nuk të lejohet, se ai të thotë unë i kam programet e mia dhe i jap vetë. Edhe shujtat e mëditjet, në qoftë se i marrim nga Granti qeveritar se me të hyrat tona vetanake nuk mund t'i mbulojmë të gjitha – dhe i qesim të shujtat dhe mëditjet, ai thotë unë marr vendim për ato mjete. Komuna ka të drejtë vetëm për të hyrat vetanake. Vlera e cila kërkohet për me i mbulue këto shujta dhe këto mëditje, e kalon shumë e të hyrave vetanake. Dhe ju e dini se nga këto të hyra vetanake ne ndajmë subvencione dhe për fermerë, kemi aktivitete sportive, një varg aktivitete kulturore. Gjithashtu, edhe në të shumtën e rasteve marrim pjesë nga të hyrat vetanake edhe në investime kapitale, dhe vlera financiare nuk ka mundësi që ne ta mbulojmë këtë kërkesë. Prandaj, në qoftë se flasim politikisht, ne jemi të gjithë pro, se nuk guxojmë me thënë se na duhen votat. Mirëpo, praktikisht, edhe pse ne themi po, për këtë arsye është zyrtari i Ministrisë së Financave dhe Transfereve që më thotë Qamil ndalu. Unë i kam qit 300 mijë euro për në bujqësi – ose i kthen në investime kapitale, ose t'i marrim krejt. Për mos me i marrë krejt, i kam kthye në investime kapitale. Prandaj, ne mundim me folë dëshira, por praktikisht ne e kemi një monitorues. Kryetari detyrimisht duhet me thënë po, se në zgjedhje është. Edhe ju keni të drejtë me kërkue, po pse jo, se edhe ju jeni të zgjedhur, po ia boni qefin krejtve. Por, ka një rregull dhe ka një monitorim, dhe kur kthehet e paligjshme, në qoftë se nuk ekzekutohet, është pjesë në Grantin e Performancës. Në qoftë se keni harrue, është komponent kryesor, në qoftë se vendimet të cilat kthehen të paligjshme Kuvendi nuk i ekzekuton, ne nuk mund të jemi pjesë e Grantit të Performancës. Dhe me këtë këmbëngulje, ne humbim edhe gjysmë million euro, në qoftë se këtë vendim nuk e ekzekutojmë. Prandaj, është më mirë të flasim shtruar, edhe të përfitojmë atë që e kemi në dorë, se shumë shpejt pritet edhe Raporti i Auditimit me na ardhë i mirë edhe me e përfitue prapë Grantin, sesa me e shkaktue një problem që për një vendim me e humb edhe një gjysmë milion. Prandaj, këtu është krejt logjika, nuk keni nevojë me u tensionue, ne e dimë që jemi në vit zgjedhor. Do të bëjmë kërkesa, shumë mirë që po bëjmë kërkesa, po duhet do gjëra edhe realisht t'i perceptojmë.

**Shpetim Hajredini:** Atëherë, po due me u lidhë me atë që e dëgjova edhe nga kryetari, po tash edhe nga drejtori i Financave. Më pëlqeu fjalimi, drejtor, tash e pranove që është politike edhe ky vendim. Edhe ju e keni pru, edhe pse e keni ditë që është i paligjshëm e nuk do të realizohet, e keni pru te na, ndoshta keni mendue që ne nuk do ta mbështesim, e të na qitni poshtë neve. Edhe fjalimet

tona, edhe pse unë vallahe nuk i bazoj asnjëherë në atë që thatë politike, kurrë, asnjëherë të vetme. Mirëpo, pak më erdh inat, se ju thashë kur e morëm vendimin, se është e paligjshme edhe kanë me na kthye prapë. Po ju na shtit me votue, thatë duhet me e votue, ne jua votuam, jua mbështetëm. Për atë, pikërisht tash unë kërkova që, një gjë që e di saktë që është shumë problem këtë vit me u realizue, kërkova që ta qesim në votim dhe ta shohim a po realizohet apo nuk po realizohet. Edhe pse e di – e di Allahu – që nuk realizohet ndoshta. 90% është që nuk realizohet. Ndërsa çështja tjetër, një propozim e dha po më duket Artani, që tha që në qershor kur ta bëjmë edhe ndarjen e buxhetit për vitin 2026, atëherë kemi mundësi ta bëjmë këtë ndarje, edhe është në rregull. Nuk besoj që pastaj ka mundësi Ministria të na kthejë prapë. Por, për rishqyrtim qëndroj prapë. Duhet ta bëjmë rishqyrtimin e këtij vendimi, dhe ndarjen e buxhetit ta bëjmë në qershor dhe në shtator ta votojmë. Ju faleminderit!

**Munir Jonuzi:** Ne në këtë kuvend kemi marrë shumë vendime të paligjshme. Kemi rrezikuar shumë herë që MAPL (MALS) t'i kthejë ato vendime. Ndoshta rreth 20 vendime të tilla – në baza ditore, sa herë që kemi mbledhje të kuvendit, kemi ndonjë vendim që duhet ta anulojmë. Dua të them se këtë e bëjmë vazhdimisht, ndërsa tani nuk mundemi sepse dikush na thotë se rrezikojmë Grantin e Performancës. Po të shikohej sa vendime na janë kthyer, kurrë nuk do ta kishim marrë Grantin e Performancës. Atje shikohen disa parametra të tjerë. Këtu merren vendime politike sepse ky është një trup politik. Ajo që doja të theksoj – si pjesëtar i komunitetit jo shumicë – është se shumë herë kemi rrezikuar, vetëm në një rast nuk kemi rrezikuar. Nuk kemi rrezikuar kur është dashur të fusim një nen në Statutin e QKMF-së për drejtor nga komuniteti jo shumicë. Për fat të keq, asnjëri nga delegatët e komunitetit shumicë nuk na ka ndihmuar. Madje shumë prej tyre na kanë penguar. Atëherë nuk kemi rrezikuar. Pse? Sepse ishte në pyetje një komunitet jo shumicë. Të gjithë e dinim që ajo vendim ishte joligjor, por e votuam – pse? Për shkak të politizimit. Çka ndodhi me nenin e Statutit të QKMF -së? Njëherë na thanë që vendimi ishte i drejtë. Dy herë na e kanë kthyer Statutin. Herën e parë thanë se vendimi është në rregull. Herën e dytë thanë se ai nen nuk është në përputhje me ligjin. Kryetari të paktën është i sinqertë – ju jeni të pasinqertë kohët e fundit. Çka kemi mundur të bëjmë? Të kërkojmë që për herë të tretë të shqyrtohej, për të parë se për çfarë bëhet fjalë. Çka bëmë ne? Për shkak të Grantit të Performancës, atë nen e kemi anuluar.

**Artan Loshaj:** Shumë u diskutua për këtë. Kryetar, tash në fund u pajtuat edhe ti edhe drejtori, që - është dashtë në fillim me folë shtruar me punëtorët – na thatë që po e bëjmë politike. Pikërisht

nga ju ka qenë politikë, se e keni ditë që nuk ju kalonkjo kërkesa e punëtorëve, keni thënë hajt po e çojmë edhe ta qesim keq Ministrinë, valle na e bëmë edhe ata nuk e dhanë, edhe qe opozita nuk e mbështetën. Domethënë, tash e pranuat edhe qytetarët dhe punëtorët poshtë le ta marrin vesh që ka qenë politikë e juaja, që 100% nuk kalon edhe e keni çue deri atje. Edhe një replikë tjetër deshta me asambleistin, kur tha që po bëhet politikë që disa kolegë kanë votuar kundër kërkesës së QKMF-së. Po, është e vërtetë, unë si asambleist kam kërkuar që të futet në këtë rend të ditës, të futet edhe kërkesa e QKMF-së, edhe disa kolegë – e kam thënë dhe prapë po e them – të cilët janë punëtorë shëndetësorë edhe kanë votue kundër vetvetes, është shumë e vërtetë. Qe ku e keni, qe edhe kamerat le ta shohin që kanë votue kundër propozimit tim që kjo pikë e rendit të ditës të futet këtu. Kanë qenë kundër edhe tash mos thuni po bëjnë politikë. Politikë unë nuk bëj, unë kam bo kërkesë, nuk më është mbështet kërkesa ime për shujtat e punëtorëve të QKMF-së, për 22 muaj. Ato QKMF ka me i fitue, se është në gjykatë. Po më vjen keq mu për punëtorët e Komunës. Faleminderit!

**Samidin Xheladini:** Munir, tri herë e kemi debatue këtë çështjen. Ti e ke marrë shumë ngat zemrës këtë punë. Askush nuk ka qenë kundër me u fut ai propozimi që ka qenë, se krejtve na ka konvenue me u bo qashtu. Edhe propozimi yt. Të jemi të sinqertë, askush nuk ka qenë në kundërshtim, as prej Qeverisë, as prej Asamblesë, që qaj nen me u fut. Tri herë kemi debatue – dy herë, edhe kryetari e dëshmoi, edhe ti po e dëshmojsh, po ne tre herë, e ma shumë herë kemi debatue për Statutin e QKMF-së. Nuk na ka pengue ajo punë, çdo send që është kundërligjore ne duhet ta vazhdojmë të ndjekim. Në këtë rastin këtu, unë jam shumë i qartë edhe e kam kuptue shumë qartë, ne jemi delegatë të cilët duhet ta votojmë. Po që se ishte në dorën e Qeverisë, ajo kishte në formën e vet, ata e dinë qysh. Por, për hir që është në dorë të këtij Kuvendi, ne e kemi përgjegjësinë për me e votue ose jo. Edhe qeveria komunale shume ka veprue drejt, për atë është demokracia. I bjer kërkesat edhe ne i votojmë, ose nuk i votojmë. Ndërsa, sa u përket propagandave, me qëllime tendencioze, ne jemi marrë vesh shumë mirë këtu në këtë Kuvend, që në mbledhjen e asaj dite me e shqyrtue kërkesën e Komunës, në mbledhjen e radhës, pasi të kthehet vendimi prej Ministrisë, ta futim kërkesën e shëndetësië. Kështu jemi dakordue të gjithë ne. S'ka pas nevojë dikush me shkue atje me pompozitet me kallxue që ai është për QKMF, e ne tjerit jemi kundër QKMF-së. As ai, as kërkush nuk ka të drejtë. Një mori kolegë më kanë thënë qysh po votoni ju kundër. A s'është turp a? Se veç disa të subjektit tjetër paskan votue për, se veç ata qenkan për Komunë, e për punëtorë, e ne jemi kundër. Kjo është shumë fyese edhe le të kenë kujdes, mos ta përdorim emrin tim, jau

ndaloj rreptësisht disa personave – me të drejtë po, por mos ta përdorin emrin tem, jau ndaloj rreptësisht, se ata duhet të merren me vetveten edhe me biografinë e vet.

**Artan Loshaj:** Këto kërcënime këtu në foltore, që kam të drejtë ose s’kam të drejtë, ky personi e di shumë mirë, se e di për kënd e ka fjalën, e di shumë mirë qysh i ka punët me mu, që 8-9 vite. Biografinë personale timen e dinë të gjithë qytetarët, a me biografinë teme me u marr, kryetar, kërcënime s’i pranoj. As nga ky, as nga ju, as nga kërkush këtu. Edhe ti e dish shumë mirë këtë problem, bile më ke thirrë në telefon – mos ta zgjasim ma shumë, mos të dalim jashtë kësaj, jashtë politikës këtu, mos ta qesim në personale, se me personale e dini shumë mirë ku jem na.

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Atëherë, pat shumë diskutime rreth këtij anulimi të vendimit për financimin e shujtave të nëpunësve të shërbimit civil. U tha e u stërtha që gjatë seancës së datës 28.02.2025 ju kemi thënë që është e jashtëligjshme. Por, çdo kërkesë që vjen është mirë që ne ta fusim në rend të ditës dhe kur të kthehet nga Ministria që kjo pikë të anulohet, ajo duhet të anulohet. Shpetim Hajredini ka kërkuar që të bëhet rishqyrtimi, por në fjalimin e dytë tha që 90% ky rishqyrtim do të kthehet prapë. Pasi që po kthehet prapë, kisha dashtë nga Shpetim Hajredini që ta sqarojë, a ka mundësi që në shtator ta planifikojmë në buxhet, siç e thajë edhe ti, për mos me dalë 90% me na u kthye edhe një herë prapë, pasi edhe vetë je ekonomist. Atëherë, në qoftë se duash, ne e qesim edhe në rishqyrtim, por ne vetë po folim që jemi jashtë ligjit, prapë tash jashtë ligjit po votojmë, një send që Ministria e ka kthye prapë. Një sqarime kisha lyp prej Shpetimit. As ne si pozitë, e as ju si opozitë nuk jemi kundër vullnetit të kësaj. Unë si kryesuese, kisha dashtë që këto të jenë të planifikuara në buxhet në shtator. Por, Shpetimit ia kisha lënë fjalën edhe e shohim qysh po shkon kjo punë më tutje.

**Shpetim Hajredini:** Po ju kërkoj falje që po detyrohem të dal disa herë në foltore për këtë çështje, më besoni që jeni ju që po më detyroni. Nuk kisha dalë, por për shkak të atyre vendimeve të cilat ju po i merrni, edhe pse po e dini ju vetë, po e deklaroni edhe vetë që janë të jashtëligjshme, e kthen Ministria prapë, ju po na detyroni neve me marrë vendim këtu, edhe sot delni në foltore edhe thoni ju s’e keni në rregull, se ka me na kthye prapë Ministria. Ju e keni ditë që ka me u kthye prapë. Kërkesa ime që ishte në fillim, për rishqyrtim dhe për ndarje të buxhetit në këtë vit, unë e di që – edhe e thashë edhe në fjalimin e mëparshëm – që nuk mund të realizohet. Mirëpo, e bëra këtë edhe me qëllim të plotë, pse ju po na bini, kur e dini vendimet që janë të jashtëligjshme, na i bini me i votue. Atëherë edhe unë po e bëj një propozim, e di që është i jashtëligjshëm, Ministria ka me na kthye prapë edhe po që se e votojmë ne këtu. Mirëpo, ishte kjo vetëm me ju dhënë një

shembull që nuk është në rregull. Ju, mos të them të gjitha, po një pjesë të madhe të vendimeve i bini që kanë bazë politike. Ndërsa unë, që katër vite, e dini ju, asnjëherë – besomni – me përjashtim të kësaj seance, që kam dalë e kam majt fjalimin dhe kam bo një kërkesë të tillë. Pak ka të bëjë me politikë, ma shumë ka të bëjë me inat. Prandaj, edhe një herë po ju kërkoj falje që u dashtë të zgjatet kjo pikë e rendit të ditës pa arsye. Dhe, po e mbështes atë propozimin i cili është i arsyeshëm, dhe po e jap si propozim timin dhe përfundimtar, që të bëjmë ndarjen buxhetore në KAB në qershor, dhe pastaj në shtator ta kemi si të plotë, dhe ta votojmë, ta mbështesim, dhe pastaj normal që e marrim edhe vendimin e Ministrisë që besoj se do të jetë në rregull. Ju faleminderit!

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit! Atëherë, siç e ceka edhe vetë, është mirë që ky vendim të anulohet sot, dhe të shkon të planifikohet në buxhetin e shtatorit, siç e kërkoi edhe z.Hajredini. Atëherë, kush është pro anulimit të Vendimit për financimit e shujtave? A ka kundër? Abstenim? Me 18 vota pro, zero kundër dhe 1 abstenim, anulohet ky vendim. Atëherë vazhdojmë me pikën e katërt: Shqyrtimi i kërkesës së OVL të UÇK-së për ndryshimin e datës zyrtare të çlirimit të Komunës së Dragashit, nga data 15 në 12 qershor. E hapi diskutimin rreth kësaj pike!

**Shpetim Hajredini:** Kjo kërkesë që ka ardhë nga OVL e UÇK-së Dega në Dragash, për ndryshimin e datës së çlirimit të Komunës sonë, besoj që duhet të ketë edhe kjo një bazë ligjore, duhet të bazohemi diku. Kush ka të drejtë ta bëjë këtë kërkesë, kush ka të drejtë të marrë këtë vendim. Ne kemi një Statut të Komunës, edhe me sa e di unë në Statut e kemi të përcaktuar datën e çlirimit të Komunës sonë që është data 15. Tash, në bazë të kësaj kërkesë, është kërkuar që kjo datë të ndryshohet dhe të kalojë në datën 12. Mirëpo, tash kush ka me ndryshue Statutin, se duhet me u ndryshue Statuti i Komunës, në të cilin qëndron data 15? Unë këtë e thashë paraprakisht, tash do ta lexoj edhe prej Statutit që e kam nxjerrë, se kush ka të drejtë, si duhet të ndiqen procedurat për një ndryshim të tillë. Neni 8.1: *“Iniciativa për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës ndërmerret nga: 1) Kryetari i Komunës; 2) 1/3 e anëtarëve të Kuvendit Komunal, dhe 3) Me iniciativën e 15% të qytetarëve me të drejtë vote në Komunë. Propozimi për ndryshimin e Statutit Komunal dërgohet tek Kuvendi i Komunës për shqyrtim fillestar. Kuvendi i Komunës, para shqyrtimit final, duhet ta konsultojë publikun në lidhje me atë propozim.”* Pra, së pari po duhet edhe një herë me hap debat me qytetarët, një periudhë kohore, dhe pastaj i tregova edhe procedurat tjera të cilat keni mund me i ndjek ju. Neni 8.3: *Pas përfundimit të periudhës së konsultimit, Kuvendi Komunal vendos a do ta miratojë Statutin me ndryshime, pas shqyrtimeve të të gjitha*

*vërejtjeve të marrura*". Neni 8.4: *"Çdo propozim për ndryshimin e Statutit të Komunës miratohet në Kuvendin e Komunës, ashtu siç përcaktohet me Nenin 12.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale."*

I nderuar ekzekutiv, e në veçanti kryetar, u mundova me ta dhënë një sqarim. Në rregull, nëse e dini, atëherë e lexova diku që ka të drejtë organizata me e prur një kërkesë direkt tek ne në Kuvend. Është dashtë të vijë tek ju, dhe ju pastaj ta bëni një gjë të tillë. Prandaj, unë po besoj që, edhe nëse sot votohet ky propozim, do të jetë i kthyer prapë nga Ministria. Sinqerisht, po më vjen shumë keq ta them këtë, mirëpo, nëse sot ne e votojmë, këtë pas një muaji e kemi mbrapshtë. Prandaj, kisha propozu që së paku ta kalojmë këtë propozim në një seancë tjetër, t'i ndjekim këto rregulla ligjore, dhe pastaj kur të na vjen, natyrisht pas plotësimit të këtyre rregullave ligjore, të na vijë në seancë. Ne nuk jemi kundër, edhe pse 24-25 vjet ne e festuam me datën që po e festojmë deri tash. Tash ka ardhë ky ndryshim, por deri atëherë besoj që kemi me marrë propozime të ndryshme prej qytetarëve, prej njerëzve të cilët e njohin mirë, si ka ndodhë, si ka rrjedhë kjo ditë e çlirimit, dhe në fund, po besoj që kemi mundësi të diskutojmë edhe këtu, Asambleja, ekzekutivi, OVL-UÇK dhe qytetarë tjerë, që të vijnë këtu, të diskutojmë, dhe ta marrim një vendim përfundimtar. Për mu, ky propozim është i ngutshëm dhe, natyrisht që nga Ministria do të na kthehet prapë.

**Emri Neshati – kryetar i OVL të UÇK-se, Dega në Sharr:** Përshëndetje kryesuese, përshëndetje kryetar, të nderuar asambleistë! I nderuar Shpetim, unë po dal kah fundi yt, kur e ceke që duhet t'i pyesim qytetarët. Qytetarët nuk pyeten, pyetet OVL e UÇK-së, kur ka ardhë, më 12 qershor. Te ligji duhet me pyet ma gjatë. Te Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative të Kuvendit Komunal, Pika 93, 94, 95,96. Kush i bën kërkesat? Ne nuk kemi lyp me e ndërrue Statutin e Kuvendit Komunal, ne kemi lyp me votë me u ndërrue vetëm data. Ne nuk bëjmë politikë, ti bën politikë, këta tjerët bëjnë politikë. Ne kemi lyp vetëm datën me e ndryshue. Në qoftë se ty të pengon data, ti mundesh me dalë me dokumente tjera, e jo me e anulue këtë. Për me dalë në një seancë tjetër, i vetmi ka të drejtë sponsoruesi i kërkesës – ligji 96. Edhe ju lus, datat i keni, në qoftë se keni mundësi ju si asambleistë, mundeni me e lyp te KFOR-i, kur ka hy KFOR-i. Mos i besoni UÇK-së, besoni KFOR-it. Sqarimin e keni pas aty, ne nuk kemi lyp me e ndërrue Statutin e Kuvendit Komunal. Ligji, unë po ta tregoj ligjin, ligji i parë, në nenin 93,94,95, që nuk ndërrohet Statuti, vetëm ndërrohet data e çlirimit. Jo e pashë, në bazë të fjalëve të këtij asambleistit të nderuar, paska problem me e ndërrue datën. Unë e lë në mbështetjen tuaj të gjithëve, kush ka mundësi me e votue, e voton, kush do, i dini ligjet, unë nuk jam për Statut me ndërrue, unë jam

vetëm për datën e çlirimit me e ndërrue. Për Statut, bën partia politike, nuk bën organizata. Faleminderit!

**Samidin Xheladini:** Zonja kryesuese, është mirë që me e lexue, për hir të njoftimit edhe të opinionit, se ne e kemi dokumentin. Unë po e shfrytëzoj rastin edhe po i njoftoj. Kur e kam marrë kërkesën, më ka pëlqye, se përkon me realitetin. Historinë duhet me e shkruie ashtu qysh është. E vërteta – e hidhur ose e ëmbël – duhet të shkruhet qysh ka ndodhë. Edhe ndoshta nuk na konvenon, por edhe na konvenon, qysh ka ndodhë, qashtu duhet të shkruhet. Po më pëlqen iniciativa e OVL – UÇK-së, sepse realiteti qetu është i shkruar, dhe i kanë kallxue faktet, që të gjithë jemi dëshmitarë se këto janë fakte të pamohueshme. Kanë kalue 26 vite dhe janë pasqyrue që janë realitet, që kanë ndodhë kështu. Dhe, pikërisht data përkon me atë që ka ndodhë. Unë me askënd nuk kam bisedue, më ka pëlqye mu si kërkesë dhe e kam parë që është e argumentuar, ashtu siç është e shkruar. Prandaj edhe e mbështes. Emria e dha një sqarim, se vetëm data, nuk ka reperkusione ligjore, a po? Atëherë, është hala ma mirë për ne, ne vetëm mundim me e votue, kështu që e përkrahi. Faleminderit shumë!

**Shpetim Hajredini:** Atëherë, duhet të jemi të qartë, se me datën absolutisht unë nuk kam të bëj fare, nëse kthehet më 12 apo më 13. Ju nëse keni argumente, atëherë mund ta ndryshoni. Mirëpo, Statuti i Komunës duhet të ndryshohet patjetër, sepse është datë me rëndësi dhe është datë e cila qendron e shënume në Statut të Komunës. Statuti patjetër duhet me u ndryshue, nëse ndryshohet edhe data e çlirimit të Komunës. Tash, ju e dini, doni me e votue apo jo. Kjo ligjërisht, ashtu si jau lexova Statutin, me nen, qëndron. Po megjithatë, e pashë edhe kryetari, tha po e dimë edhe na këtë, e kemi lexue. Prandaj, s'kam nevojë ma tepër me sqarue, po vetëm deshta të jem i qartë me OVL UÇK, Dega në Dragash, që nuk jam kundër ndërrimit të datës, absolutisht jo. Mirëpo, kam dëshirë që mos me na i kthye prapë vendimi, se pastaj po duhet me diskutue edhe një herë dhe me kalue në politike. Tash kjo nuk është politike, nëse na kthehet prapë, atëherë kalojmë në politike. Ju faleminderit!

**Nexhat Selaj:** Përsëritje kryetar, kolegë asambleistë! E dëgjova me vëmendje edhe kryetarin e OVL UÇK-së, por edhe diskutimet e kolegëve. Do t'i drejtohem pak kryetarit të OVL UÇK-së, që thotë duhet ta votoni. I nderuar kryetar, Gabimet të cilat i bën për momentin pozita, çon ligje dhe na kthen mbrapa, nuk është shumë madhore, pavarësisht se e ka një peshë. Po ta çojmë ne një vendim të OVL UÇK-së dhe të na kthehet prapë, dalim shumë qesharakë. Për këtë arsye, unë po mendoj se e kemi personin ligjor këtu, le ta shfletojë ligjin. Nëse nuk biem ndesh me ligjin, atëherë

detyrimisht, se kush është kundër asaj për me e mbështet? Por ta çojmë një propozim të OVL UÇK-së dhe të na kthejë prapë Ministria, kjo është katastrofë për të gjithë. Mos të ngutemi në veprim, personin ligjor e kemi këtu. Nëse kemi bazë ligjore të drejtë, unë nuk e besoj – nga 27 asambleistë sa jemi këtu, 28 e votojnë. Asnjë nuk është kundër, vetëm të jemi të sinqertë. Faleminderit!

**Arijeta Skeraj:** Siç e dini, çdo kërkesë që vjen, ne e qesim në Kuvend. Por, unë sa e kuptova – i kërkoj falje Shpetimit, ai nuk ishte kundër ndërrimit të datave, por ai ishte që kjo pikë të jetë sa më mirë dhe të mos kthehet prapë. Nuk tha që jam kundër, nuk tha që do të jem kundër ndërrimit, por ky e pat si qysh e pat te rishqyrtimi. Edhe pse ke shumë i pasaktë, 90%. Tash, do ta marrim një pesë minuta, unë, ti edhe kryetari, që kjo pikë të jetë. Besoj që të gjithë asambleistët jemi pro kësaj, se e dimë që jemi çlirue më 12, po unë sa e kuptova, Shpetimi tha që mos të na kthehet prapë. Ju kisha lut 5 minuta, që ta kemi një takim, unë, Emria dhe kryetari, edhe një përfaqësues.

**Emri Neshati:** Ju mos e votoni, le të kthehet ligji, në qoftë se janë të kundërligjshme, le të kthehet ligji. Na sivjet po e manifestojmë më 15 qershor. Kqyrni ligjet, mblidhuni partitë politike bashkë, ndërrone Statutin. Thaje dhjetë herë, unë të dëgjova, thaje politikë, politikë. Ti tash e bërë vetë politikë, me dy fjalë tuat. Ku më preke mu më së shumti, që t'i vesim 15% të qytetarëve, a qytetarët me bo kërkesë. Jo qytetari, zotëri, kërkesën e bën OVL UÇK, për ndryshim të datës. Unë s'po bëj kërkesë për me e ndërrue Statutin e Komunës, s'e di sa po më kuptojsh? Kalofshi mirë!

**Arijeta Skeraj:** Atëherë, pesë minuta edhe kthehemi në sallë!

Të nderuar asambleistë, pas këtij pushimi shumë të shkurtë, pesë minuta, që ishte për shqyrtimin e kërkesës së OVL UÇK-së, në fillim fjalën e ka lyp z.Nedžmidin Sejdilar dhe pastaj do të vazhdojmë me pikën.

**Nedžmidin Sejdilar:** Faleminderit! Unë e mora fjalën veç me thënë që e përkrah kërkesën për ndryshimin e datës. Po du veç me ju thënë, ta bëjmë këtë çështje sa më sagllam, qysh duhet, të mos kemi ndonjë problem masanej pse keni gabuar me ligjin. Se në çdo formë që e doni, që e don organizata OVL UÇK, e përkrah këtë kërkesë. Ju faleminderit shumë!

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit! Atëherë, të dashur asambleistë dhe ju media, Shpetim Hajredini për shqyrtimin e kësaj kërkesës nuk ishte kundër që kjo datë të ndërrohet, por sikur edhe te pika e tretë, Shpetimi e kishte qëllimin që çdo pikë të kthehet e ligjshme, të mos kthehet e paligjshme. Arsyeja pse e tha z.Shpetim Hajredini, tha se shumë më mirë është të ndërrohet Statuti që kjo pikë të mos kthehet. Atëherë, a do dikush me e marrë fjalën, apo do ta qesim drejt e në votim? Do ta japish

edhe sqarimin për hir të opinionit, për një kërkesë që ka ardhë nga OVL e UÇK-së, pa marrë parasysh bindjeve politike.

**Shpetim Hajredini:** Faleminderit! Ju kërkoj falje të gjithë qytetarëve nëse e kanë keqkuptue diskutimin edhe fjalimin tim, edhe pse unë besoj, për ata të cilët kanë pak njohuri, e kanë kuptue se çka kam dashtë me thënë unë. Unë e kam lexue nenin i cili i takon Statutit të Komunës së Dragashit, të vitit 2008, Statut i cili është ndryshue për herë të fundit në 2008-tën. Dhe, atë që e kam lexue, ashtu është dhe ashtu qëndron, dhe nuk jam absolutisht kundër ndërrimit të datës, sepse personalisht as unë nuk e di, kam qenë i ri edhe atëherë nuk e di çka ka ndodhë. Kompetent për këtë çështje janë OVL UÇK, të cilët besoj që kanë njohuri të duhura për datën e çlirimit të Dragashit dhe, natyrisht, si përfundim, po e ritheksoj edhe një herë, nuk jam kundër ndërrimit të datës. Jam kundër kthimit të vendimit, vetëm kaq! Ju faleminderit!

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit! Atëherë e qesim në votim! Kush është pro miratimit të kërkesës së OVL të UÇK-së për ndryshimin e datës zyrtare të çlirimit të Komunës së Dragashit, nga data 15 qershor në datën 12 qershor? A ka kundër? Abstenim? Me 21 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet pika e katërt e rendit të ditës.

Po fillojmë me pjesën e dytë të seancës. Besoj që keni kaluar mirë! Atëherë, kemi mbet te pika e pestë e rendit të ditës, ishte propozim nga Nedžmidin Sejdlari, formimi i komisionit për verifikimin e veturave të QKMF-së të cilat janë më të reja se tri vite. A do dikush me e marrë fjalën?

**Behar Brenoli:** Më vjen keq që duhet të flas përsëri për një temë që e kemi diskutuar disa herë këtu. Nuk e di pse po e ngritni përsëri këtë çështje. Meqë keni kërkuar, tani do t'jua sqaroj. Nuk e di sa kam arritur të kuptoj, dikush nga asamblistët është ankuar se kemi blerë disa vetura që janë të vjetra, megjithatë, këtu kemi dy leje qarkullimi për dy vetura që i kemi blerë në vitin 2022, mund të shihen nga të gjithë. Kushti atëherë ishte që veturat të jenë të prodhuara në të njëjtin vit, pra 2022 dhe kjo shihet në leje, viti i prodhimit është 2022 për të dyja veturat. Dikush këtu me qëllim të caktuar po dëshiron të shpërndajë gënjeshtër të ndryshme, nuk e di cili është qëllimi, por është shumë e ulët dhe e ligë. Sa i përket pretendimit se kemi servisuar vetura që kanë qenë nën garanci, edhe kjo është një gënjeshtër e madhe – keni dëshmi. Edhe më parë keni kërkuar komision për të verifikuar veturat, i keni marrë të gjitha faturat për shqyrtim. Tani po e bëni të njëjtën gjë përsëri. Kjo është kontrata për blerjen e veturave nga data 26/10/2022, në kontratë kompania ka dhënë garanci për 24 muaj. Nga 26/10/2022 deri më 26/10/2024 ato vetura kanë qenë nën garanci. Me

përgjegjësi deklaroj që asnjë nga ato vetura nuk është servisuar. Përveç kur ka qenë kompania që i ka mbuluar me garanci. Ne si komunë nuk kemi paguar asnjë cent për ato vetura. Kjo është e vetmja e vërtetë, më vjen keq që vazhdimisht e ngriheni këtë temë. Mund të vini, mund t'jua lë këto dokumente, nëse nuk na besoni, shkoni në prokurori.

**Munir Jonuzi:** Paraqitja ime për këtë pikë të rendit të ditës është ekskluzivisht mbi bazën e sqarimit të drejtorit të shëndetësisë. Nëse dikush ka ndonjë problem, le t'i drejtohet prokurorisë. Z. Drejtor, ne këtu nuk jemi prokurorë publikë, ne jemi delegatë që duam të dëgjojmë të vërtetën. Ju vini këtu, siç erdhët tani, dhe tregoni: “kështu kemi vepruar”. Ne nuk duam procese gjyqësore këtu, as çështje që nuk janë në kompetencën tonë. Në kompetencën tonë është të bëjmë pyetje në mënyrë që qytetarët të informohen për punën e pushtetit ekzekutiv. Dhe jo të na thonin të shkojmë te prokurori. Prokurori ka kompetencat e veta dhe ne kemi tonat. Detyra jonë është t'ju pyesim, detyra juaj është të na jepni përgjigje.

**Bexhet Xheladini:** Unë isha kryetari i cili, pas insistimeve të vazhdueshme të z.Sejdilar që të formohet një komision për këto automjete të cilat, sipas tij, janë blerë të vjetra. Unë menjëherë e kam thirrë drejtorin e Shëndetësisë dhe i kam thënë, të lutem m'i siguro të gjithë dokumentacionin e këtyre automjeteve. Me sa e di unë, sa jam kryetar, ne asnjë automjet të vjetër nuk e kemi blerë, as në shëndetësi, as në Komunë, as askund. Në shëndetësi janë blerë dy automjete, siç tha drejtori, edhe një automjet na është falë Ministria e Shëndetësisë. Këto dy automjete, për 24 muaj u janë bërë servisimet pa pagesë nga kompania që është sigurue. Pas 24 muajve, këto dy automjete dy herë kanë qenë në servisim – i kam të dy faturat, në të dy këto fatura shkruan çka i është ndërrue këtyre. Këto dy fatura, pas 24 muajve, janë bërë me pagesë të mjeteve financiare të Komunës së Dragashit. Njëra faturë është 352 euro, tjetra është 171 euro. Unë e kisha lut drejtorin që t'i fotokopjojë këto dokumentacione, edhe t'ia japë z.Nedžmidinit, edhe nëse ai dyshon diçka, janë organet kompetente që ai mundën, me këto dokumentacione, me marrë masa, me e paraqit rastin. Ani se tha drejtori, ai e tha me të drejtë, nëse dikush dyshon që ka keqpërdorim – dokumentacionin komplet do ta marrish edhe do ta kesh në pronësi, drejtori do ta fotokopjojë, edhe do ta shohësh që asgjë nuk ka të vërtetë për atë çka ke thënë që dy vjet e gjysmë. Qe disa herë në Asamble e ke potencue. Gjithashtu, ne vitin e kaluar, kur kemi dashtë krejt Asambleja me dalë e me i pa këto automjete, opozita e ka kundërshtue, nuk keni dalë. Kështu që, tash e ke dokumentacionin, edhe në bazë të dokumentacionit mundesh ti lirisht – edhe le të jetë kjo hera e fundit që për këto automjete, të isha lut që këtë çështjen e propagandës më ta përfundosh. Dokumentacionin do ta

kesh në dispozicion, edhe është në dorën tënde, çka të duash mujsh me bo, mujsh me shkue edhe me e paraqit rastin, nëse dyshon diçka. Faleminderit!

**Nedžmidin Sejdilar:** Kryetar, mendoj se nuk e kuptoni mirë gjuhën tonë. Nuk kam thënë që keni blerë vetura të përdorura. Kam thënë që të shohim fizikisht 5 vetura që janë sjellë në komunë gjatë mandatit tuaj, si duken. Ne e dimë që QKMF dhe komuna kanë shumë më shumë vetura. Drejtori përdor terma të papërshtatshëm për Kuvendin. "I lig" dhe "gënjeshtër". Imagjinoni nëse unë, që jam i talentuar, filloj të përdor këta terma, si do ndiheshit ju? Kjo nuk është për mua. Pse keni frikë nga një komision? Këtë e bëj për ju, z. Kryetar. Nuk dyshoj në ndershmërinë tuaj. Cili është problemi nëse formohet një komision që do të hetojë të gjitha pretendimet dhe i dorëzon raportin Kuvendit? Sa i përket prokurorisë, unë jam njeri që respektoj vlerat fetare, nuk padis askënd, vetëm mbrohem nëse dikush më padit. Edhe nëse më qëlloni, nuk do t'ju padis. Bindjet e mia fetare nuk më lejojnë të kërkoj drejtësi në gjykata. Drejtësia i përket vetëm Zotit. Nuk kam procese gjyqësore me askënd. Pse keni frikë nga një komision? Të gjitha informacionet i kam marrë nga dokumentet tuaja, debatet në Kuvend, dokumente të nënshkruara personalisht nga drejtori juaj që kanë kaluar përmes këtij Kuvendi. Që kam aftësi të gjej gabime në dokumentet tuaja, është talenti im.

**Agron Gashi:** Zotëri Sejdilar, ju dëgjova me vëmendje. Kërkesat dhe ankesat tuaja, të gjitha. Por megjithatë, këta asambleistë kanë të drejtën, edhe në Zyrë të Prokurimit, edhe nëpër drejtori, nëse shohin anomali, shohin keqpërdorime apo diçka tjetër që ka të bëjë me korrupsionin, është e drejtë legjitime dhe, qysh thanë më herët, që të ngresh padi nëpër gjykata dhe në instanca tjera. Mos të formojmë komisione, se komisionet janë jo të arsyeshme. Ne jemi asambleistë, përcillni zhvillimet, çdo gjë që ndodh brenda kësaj Komune, nëse sheh pengesa, padrejtësi, bëhet kërkesa nëpër drejtori, nëpër Zyrë të Prokurimit, ku duesh me marrë informacione, kanë të drejtën legjitime patjetër me ta dhënë informacionin, dhe atëherë vazhdo procedurat. Por, kjo me hamendje, ka ose s'ka, bëhet apo s'bëhet, kjo është diçka vetëm humbje e kohës. Faleminderit shumë!

**Nedžmidin Sejdilar:** I nderum koleg, më duket se edhe ju përkthimin e keni keq. Prandaj, qe po ju flas shqip, se unë jam njeri tolerant edhe kur diçka nuk kuptohet, me aftësi të mia, sa muj, shqip po ju drejtohem. Nuk e di pse pushteti po frikësohet prej këti komisioni. Unë nuk e akuzoj. Unë prapë po ju them, krejta informatat pse insistoj në formimin e këtij komisioni, e kam marrë nëpër materialin që na keni pru ju nëpër Kuvend. Dokumentat të cilat i kam lexue unë janë të nënshkruara me dorën e vetë drejtorit. Si ai raporti famoz që u nënshkrua me dorën e vetë drejtorit, për 22 mijë vaksina kundër Covid-it në vitin 2024. Covid-i u kry moti, ne i kem vaksinuar 22 mijë veta këtu

për Covid. Unë prapë po ju them, aftësitë e mia janë superiore. Unë mund të lexoj tash diçka, edhe mos me ju thënë, me prit edhe një dokument që është kontradiktor nga ana juaj, e atëherë me ju kap. E unë po dyshoj, unë nuk po them që pushteti është fajtor, unë nuk po them që nuk është ashtu. E dyta, unë e kam për imazhin e kryetarit. Kryetari është i pari i Komunës, ai është edhe kryetari im. Personalisht nuk e kam përkrah, ka qenë vendimi i partisë sime, kështu nuk e kam votuar se e kam respektu vendimin e partisë edhe kam pas të drejtë mos me votu. Populli shumica e ka votu, e kanë prurë si kryetar, unë e respektoj si kryetar. A mundet kryetari me dalë këtu e me thënë një herë që nuk e kam respektu si kryetar? A mundet me dalë një herë me thënë Nedžmidini nuk m'u ka drejtu me fjalët "i nderum kryetar" ose diqysh? Po ju them, sipas dokumenteve që i keni prurë në Kuvend, të juajat, që kanë kalu në këtë Kuvend, unë kam dyshim. Puna e prokurorisë, unë për arsye fetare nuk shkoj as në prokurori, as në gjykatë. Unë vetëm shkoj edhe në gjykatë, edhe në prokurori, kur kam nevojë me e mbroj veten. Unë asnjërin nuk e çoj në gjykatë, as në prokurori. Puna ime edhe obligimi im, edhe vendi im i punës është që ma ka dhënë qytetari, mandatin, është në këtë Kuvend. Edhe unë kërjta këto shqetësimet do t'i ngris në këtë Kuvend, edhe po ju lutem, pse bre po frikësoheni. E formojmë, e kqyrim, ishalla raporti del super për ju, ma mirë për ju, për qytetarët, për krejt. Ju faleminderit!

**Behar Brenoli:** Kur dikush gënjen, ai gënjen. Nuk e di nëse ka ndonjë fjalë tjetër për këtë. Nuk ka nevojë të zbutet apo të paraqitet ndryshe – kush gënjen, gënjen. Ashtu siç gënjyet pak më parë mbi disa dokumente, nuk e di cilat, por që nga kur është bërë Xheladini kryetar, janë blerë vetëm 2 vetura. Ju thatë 5. Përsëri gënjeni. Nuk e di në bazë të cilës dokumentacion, por përsëri gënjeni. Kjo është e vetmja e vërtetë dhe nuk ka nevojë të diskutojmë përsëri për këtë temë. Sa i përket komisionit, në ndonjë nga seancat e kaluara e keni pasur si pikë të rendit të ditës për të parë veturat, nuk keni ardhur për t'i parë. Lirisht shkoni lart, shikoni çfarë të doni. Ju gjithsesi shkoni shpesh atje, e maltretoni stafin e QKMF-së. Të dyja veturat janë aty sot, si dhe vetura për dializë.

**Nedžmidin Sejdilar:** Drejtori del në foltore, sillet pa edukatë dhe me arrogancë. Nuk tha asgjë të dobishme. Vetë mënyra si u afrua në foltore tregon që është i tronditur psikikisht dhe i frikësuar. Kam dyshime të bazuara në dokumente që drejtori po bën gjithçka për të penguar formimin e një komisioni që do të hetonte rregullsinë e tij. Nuk mund ta kuptoj – nëse pushteti dhe drejtori janë të rregullt, për hir të qytetarëve duhet ta hetojmë. Pse keni frikë nga formimi i një komisioni nëse jeni të rregullt? Kulmi i punës suaj është kur Kuvendi jua miraton raportin. Pse drejtori frikësohet nga kjo? Kjo do t'i ndihmojë edhe kryetarit. Unë ju besoj juve, por qytetarët nuk ju besojnë. Unë

vetë kam gjetur shumë kontradikta në dokumentet tuaja. Drejtori thotë se unë shkoj shpesh në QKMF dhe e maltretoj stafin – si? Kam dëshmitarë që sillen me kulturë atje. Me këtë ai nxjerr insinuata. A nuk i kam thënë personelit me përparëse të bardhë se është turp të emërohet dikush me 37 ditë përvojë pune si zëvendës drejtor i QKMF -së, sepse kështu fyhen ata që kanë punuar për vite të tëra atje? As Esati nuk mund të thotë se kam keqtrajtuar dikë atje. Unë kam të drejtë të shkoj atje dhe të përdor të gjitha shërbimet që ofrohen. Pse keni frikë të formoni një komision që do të hetojë gjendjen në shëndetësi? Hajde ta dokumentojmë. Drejtori në vend që të më falënderojë sepse po ia rris vlerën politike, më ofendon rëndë, ndërsa kryesuesja hesht. A i kam thënë dikujt ndonjëherë që është i lig? Asnjëherë nuk jam drejtuar pa sjellje të kulturuar. Ju lutem kryesuese, ndaloni përdorimin e termave si “i lig” nga kjo foltore. Unë nuk i kam thënë askujt se është i lig. Cilat janë parametrat për ligësinë? A duhet të më marrë Behar ndonjë shtupë të më kontrollojë nëse jam i lig? Kjo është sjellje e turpshme nga një drejtor super i suksesshëm. Pse keni frikë? Në bazë të dokumenteve, të hartojmë një raport që do të jetë në favorin tuaj. Kërkoj formimin e një komisioni për të hetuar veturat – që unë lexoj çdo dokument është problemi juaj. Nuk ka nevojë që drejtori të sjellë lejet e qarkullimit, do të sjellë dokumentet kur komisioni t’i kërkojë. Ju me qëllim po doni të shkaktoni konflikt në këtë sallë. Me mirësjellje po e them: kërkoj të formohet një komision, të hetohen të gjitha pretendimet, Behar të sjellë të gjitha dokumentet, dhe unë do të jem më i lumturi nëse raporti del pozitiv – kjo do t’ju ngrisë vlerën edhe juve. Këtë po e bëj më së shumti për ju, z. Kryetar – ju mund të bëni gabime në sport, në kadastër, por si mjek i shkëlqyer me imazh të mirë, kjo është në favorin tuaj.

**Samidin Xheladini:** Ne e formojmë komisionin me vota unanime, se jemi transparentë. Çdo send dona transparentë me qenë. Por, ndërkohë drejtori dha sqarime që ishin bindëse për mua. Parafolësi i foli disa fjali, e kallxoj një gjuhë të vërtetë. Unë jam provokues – tha – edhe ju bëj kështu, e ju bëj ashtu. Ti po luan me dinjitetin tonë, a? Unë jam kundër formimit të komisionit!

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Atëherë, siç e dini, kjo kërkesë ka qenë edhe më herët në Kuvendin e Dragashit dhe e kemi qit si pikë të rendit të ditës që ta formojmë komisionin. Unë i jam drejtuar drejtorit të Shëndetësisë, z.Behar Brenoli, ai më ka prit shumë mirë dhe ka thënë që jemi në gjendje edhe të gjitha autoambulancat që janë blerë me i pru para Komunës. Atëherë kur janë pru, z.Sejdilarin e kam lut që të dalim të gjithë së bashku t’i shohim, atëherë nuk ka dashtë që të dalë edhe t’i sheh. Arsyen pse nuk ka dashtë të dalë e di veç ai. Edhe unë do të jem – sikur z.Xheladini – kundër këtij komisioni. Arsyeja është se – jo që ne

nuk duam me e ditë që a ka atje diçka që po shkon keq – por siç e përmendi edhe kryetari i Komunës, edhe drejtori i Shëndetësisë, me fakte që të dy veturat janë, dhe janë të vitit 2022, që kur ka ardhë në qeverisje z.Xheladini, edhe me çmime tregoi se sa u kanë bërë servis atyre autoambulancave. Atëherë, unë pse me e bo komisionin, kur ne nuk jemi komision hetues me shkuar me procedura më të larta. Atëherë, propozimin e Sejdilarit e qesim në votim! Kush është pro që të formohet një komision? A ka kundër? Abstenim? Me 8 vota pro, 11 kundër dhe zero abstenim, nuk formohet komisioni për verifikimin e veturave të QKMF-së. Atëherë, vazhdojmë te pika e gjashtë: Pika eventuale.

**Nexhat Selaj:** Kryetar, i kam nja dy pyetje të dedikuara pikërisht për ju. Në seancën e kaluar ta kam paraqit një pyetje, juve edhe drejtorit të Arsimit, që më tha se do të jap përgjigje në seancën e radhës. Fjala ishte për bartjen e nxënësve, transferet nga një shkollë me drejtim të ndryshëm, në shkollën “Ruzhdi Berisha”, në drejtimin e Farmacisë. Thaje nuk e di ligjin, do ta shikoj dhe do t’ju servoj ligjin i cili lejon. Bëhet fjalë për një nxënës i cili e kishte një transfer nga Prizreni dhe erdhi e u regjistrua në Infermieri, që nuk i takon atij profili arsimor. Unë me sa e di, Udhëzimi Administrativ nuk e lejon. Ju thatë do ta sjellim dokumentin që e lejon. Deshta ta di vetëm a e ke sjellë atë dokument, apo jo. Edhe pyetja e dytë, vjen një shqetësim nga Kryesia e fshatit Zym dhe banorët e fshatit Zym, për investimet e parapame po në të njëjtin fshat, për në Zym. Prioritet keni pasur për këtë vit urën në Qollopek, e cila përafërsisht gati është krye, kam qenë në vendin e ngjarjes e kam vërejt. Dhe, prioriteti i dytë ka qenë investimi pikërisht në trasimin dhe shtrimin, e kubëzimin e rrugës prej shkollës deri tek Fusha. Me Kryesinë e fshatit që më kanë ftue, kam bisedue – ju e kishit pas një takim po më duket, para nja dy javëve apo tri, nuk jam i sigurt – dhe ju keni premtuar se ai kubëzim i rrugës do të filloj dhe do të kryhet. Por, realiteti nuk është ky, pasi që ju nga ky premtim keni devijue intervenimet, ato investimet në fshatin Zym, pikërisht keni hapur një mur në Qollopek, e nuk keni parë prioritet rrugën e kubëzuar nga shkolla drejt fushës. Unë pak më parë, para nja gjysmë ore pata edhe këtu Kryesinë e fshatit, në përbërje prej tre personave, të njëjtit të cilët i ke ftue në takim, edhe iu thashë se do ta qes këtë çështje, do ta pyes edhe kryetarin. Ata presin një informacion zyrtar se çfarë do të bëhet. Faleminderit!

**Driton Ademi:** Atëherë, pak a shumë e bërë pak me dije unë si në pikë eventuale. Kryetari është mirë – edhe pse është pak a shumë nëpër media, po pasi jemi edhe live këtu në media – është mirë me na informue, le t’i informojë edhe qytetarët, për fushatën e informimit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, cilat zona dhe orët kur kanë me u mbajt. Faleminderit!

**Shpetim Hajredini:** Atëherë, unë e kam më shumë si propozim sesa si pyetje, i nderuar kryetar. Pasi veç jemi afër planifikimit të KAB-it, kam një shqetësim. Para katër-pesë ditëve, besoj ndoshta se si problematikë ia kanë hap edhe Resulit, nuk po e di nëse e kanë kontaktue apo jo. Çështjen e shtratit të lumit. Pas vërshimeve ti e dish gjendja qysh ka qenë. Keni intervenue një pjesë, po më duket KFOR-i Turk qatje në fillim s’di çka ka punue, ka bo diçka, ka ndërhy. Mirëpo, brenda fshatit nuk është prek asgjë, edhe tek Mahalla e Pashtrajve, unë vetë nuk kam kalue aty pari, por më lajmëruan që është rrezik. Edhe nëse ka vetëm pak vërshime, ata thanë që ka mundësi me na dalë jashtë prapë. Atëherë unë nga sot po e bëj si propozim, që ta keni parasysh, në KAB të planifikoni buxhet për rregullimin e shtratit të lumit të fshatit Kuk. Ju faleminderit!

**Nedžmidin Sejdilar:** Faleminderit. Në ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës, kam kërkuar nga Kuvendi që të formojë një komision për të zgjidhur çështjen e rrëshqitjes së gurëve drejt Kruševës. Nuk kam hasur në mirëkuptim – mora përgjigje që mirëmbajtja e rrugës bëhet nga niveli qendror, pra nga qeveria. Kjo është e saktë. E pranoj faktin që rruga është e qeverisë, por gurët që rrëshqasin janë nga ana e komunës. Rruga nuk është aq dramatike sa gurët që bien nga anët. Për sigurinë e qytetarëve kërkoj këtë. Komuna ka për obligim të parandalojë rrëshqitjen e atyre gurëve – hajde ta zgjidhim bashkë këtë problem për ata njerëz. Komisioni nuk mori votat e mjaftueshme që kjo çështje të kalojë. Do ta lë publikun të gjykojë kush ka të drejtë e kush jo. Vetëm një pyetje për kryetarin: 20,000 vaksina për Covid – ku janë përdorur? Covid ka kaluar moti. Imagjinoni ta lexojë këtë raport OBSH-ja, do të na shpallë karantinë. A mundet ndonjëherë drejtori të na e shpjegojë këtë? Qëndron në raport. Gjëja e tretë – ju lutem lexoni vetë raportet që Behar i ka shkruar me dorën e tij prej 2022–2025 dhe gjykoni vetë. Për veturën famoze – qytetarët e dinë vetë. Vetëm të na shpjegojë si ndodhi pandemia e virusit në vitin 2024.

**Bexhet Xheladini:** Unë i mbeta borxh zv.kryesuesit për pikën e dytë të rendit të ditës, ku u diskutua për Raportin për realizimin e buxhetit për periudhën Janar-Mars 2025. Bëhet fjalë për furnizimet mjekësore. Unë i gjeta dokumentacionet, i gjeta edhe faturat, edhe kontratat. Unë si kryetar i Komunës, me ndërmjetësim të Zyrës së Komuniteteve, me nje OJQ “Advancing Together”, kam nënshkruar një memorandum të bashkëpunimit financiar, ku 60% e mjeteve do t’ia paguajë kjo OJË, ndërsa 40% të mjeteve do të paguhet nga Komuna e Dragashit. Nga këto mjete, 25 mijë euro ne i kemi ndarë për financimin e tri projekteve; projekti i Papa Testit, projekti i ndërtimit të një ordinancës stomatologjike në katin e parë të ndërtesës së QKMF-së për persona me nevoja të veçanta, dhe pjesa tjetër e mjeteve është pague për reagnsa, kompanisë Atom Med, e

cila qe një kohë të gjatë bashkëpunon me QKMF-në për furnizim me barna. Gjithashtu, në mbledhjen e kaluar njëri prej delegatëve këtu ka thënë se në fshatin Kuk nuk ka pas dru shkolla e fshatit, dhe si pasojë e kësaj fëmijët janë kthye të mërdhirë në shtëpi. Unë para disa ditëve jam takue me drejtorin, dhe ai ka thënë jo që shkolla e Kukit ka pas dru të mjaftueshme, ka edhe sot, edhe ka dru me iu dhënë edhe shkollave tjera, dhe në asnjë moment nuk ka ndodhë kjo që është thënë në Asamblenë Komunale. Dhe, më ka thënë nëse duesh më thirr në telefon në momentin kur të dalish para foltores, edhe unë këtë e demantoj, por muj me ardhë edhe në Asamble me e demantue. Dhe, personi – tha – që ka folë, në atë klasë që i ka fëmijët, është aq klasë e nxehtë, sa që i çelim edhe dritaret për me u ajros. Kjo është ajo që i mbeta borxh nga seanca e kaluar. Sa i përket pyetjes së z.Selaj, për transferin e nxënësve unë e kam dhënë një sqarim në seancën e kaluar. E kam thirrë edhe zyrtarin ligjor, i cili ma ka pru dokumentacionin, edhe më ka bind që kërkesa është ligjore. Në seancën e kaluar ka qenë drejtori këtu, i përgatitur me e dhënë këtë përgjigje, po ju nuk keni qenë këtu. Kështu që, në seancën tjetër ai vjen prapë, ose i them me ta pru dokumentacionin, ta jep personalisht, e shohish. Mua nuk më ka pëlqye kjo as mu, nga frika se do të bëhet dukuri edhe do të kemi ne pasoja. Për atë kam thënë se ne si Kuvend Komunal, për shtator ta marrim një qëndrim paraprak që mos me ua mundësue më me ndodhë gjëra të tilla, po që janë ligjore. Nuk është që është bërë transferi i një nxënësi që nuk është ligjor, por janë zbatue të gjitha procedurat që i kërkon ligji. Sa i përket Kryesisë së fshatit Zym, unë ka ndoshta dy javë që i kam pranue, edhe e kam paraqit shqetësimin tuaj që në Asamble çdo herë në emër të fshatit po kërkon sqarime, ata më kanë thënë kështu: Na vjen mirë, por z.Nexhat Selaj nuk ka të drejtë në emër tonë me dalë me folë edhe tërhiqnja vërejtjen që ne folim në emrin tonë, Nexhat Selaj nuk jeton më në Zym, por jeton në Dragash. Atë m’i kanë thënë mu në zyrë këto fjalë, tre përfaqësues të Kryesisë, më kanë thënë z.Nexhat Selaj nuk jeton aty, edhe ne jemi të kënaqur me punën tuaj, me punën e kryetarit. Këto fjalë m’i kanë thënë në zyrë. Edhe una ua kam sqarue çka është punue në Zym, edhe çka planifikohet të punohet sivjet. Çdo gjë në Zym do të punohet sipas asaj që e keni miratue ju në Asamble Komunale, të gjitha ato projektet. Mund të ndodhë të ketë vonesa, sepse është në procedurë hartimi i projekteve, por ato të cilat i ka miratue Asambleja Komunale, shumën buxhetore edhe emrin e projektit, do të zbatohen në fshatin Zym. Dritoni kërkoi nga unë që të jap sqarime, megjithëse këto sqarime i ka dhënë edhe Tv Opoja, edhe Radio Sharri, sa i përket fushatës vetëdijesuese për Rindërtimin e Kadastrit. Unë do ta lexoj këtu një njoftim që ka dalë. Unë si kryetar i Komunës, vitin e kaluar – jo vetëm unë, por të gjithë kryetarët e komunave – kanë

nënshkrue marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë dhe Agjencionin Kadastral të Kosovës, ku në katër zona në Komunën e Dragashit do të ndodhë rindërtimi i Kadastrit, ku qytetarët e Komunës sonë – janë katër zona, dy në regjionin e Opojës, dy në regjionin e Gorës - do të kenë mundësi që të gjitha transaksionet kadastrale t’i kryejnë pa pagesë. Edhe rindërtimin e Kadastrit, edhe ndarjet e parcelave, edhe bartjet e pronave, edhe korrigjimet e ndryshme. Kështu që, kjo fushatë vetëdijesuese do të jetë nëpër këto katër lokalitete: Bresanë, Dragash, Leshtan dhe në Pllajnik. Qytetarët e këtyre katër lokaliteteve do të kenë mundësi që t’i bëjnë këto përmirësime. Për datën e mbajtjes së këtyre takimeve ne do t’i qesim në uebfaqen e Komunës, megjithëse janë këto të qitura, por megjithatë, mos me hup kohë me i lexue, do t’i qesim sot për informim në faqen e Komunës. Por mund edhe ta lexoj: në Dragash do të mbahet më 30 prill, në ora 16:30 – 17:30, në sallën e Kuvendit Komunal; Zona Kadastrale Leshtan ora 18:15-19:15, shkolla “Fetah Sylejmani” Leshtan; e premte, 2 maj, Zona Kadastrale Pllajnik, ora 16:30-17:30, shkolla “Samidin Emini” në Pllajnik; dhe Zona Kadastrale Bresanë, ora 18:15-19:15, Shtëpia e Kulturës “Alajdin Xhezairi” në Bresanë. Këta qytetarë mund të shkojnë aty edhe të marrin informata të mjaftueshme nga personat kompetentë të AKK-së. Sa i përket pyetjes së Shpetim Hajredinit për shtratin e lumit, ne këtë vit, me mjetet që i kemi do të fillojmë pastrimin e shtratit të lumit, do të bëjmë disa kubëzime dhe do të fillojmë me ndërtimin e disa mureve. Gjithashtu, për vitin 2026 do të parashohim mjete të mjaftueshme që ky projekt edhe i lumit, edhe i urës, edhe i mureve mbrojtëse, të përfundojë në fshatin Kuk. Mirëpo, pastrimi i lumit ka me ndodhë sivjet, edhe një pjesë e kubëzimeve, edhe një mur mbrojtës. Sa i përket rrugës te Krusheva, unë e dhashë herën e kaluar përgjigjen. Lojë fjalësh janë ato, jo rruga është e Ministrisë, jo gurët janë të Komunës. Unë të thashë kështu, ne nuk jemi ekspertë me shkue aty me bo komisione, me vlerësue, kur Ministria i ka ekspertët e vet edhe sigurisht që ka me u marrë me atë pjesë të rrugës, sepse ne e kemi bërë informatën zyrtare në Minsitri për problemin që ekziston në atë pjesë të rrugës, në mes të Krushevës edhe Gllloboqicës. Gjithashtu prapë e përsëriti punën e komisionit, por ju zotëri nuk jeni i sinqertë. Unë me dokumentacion po të them, se gjatë mandatit tim i kemi blerë vetëm dy automjete edhe një automjet na u falë, edhe dy traktorë. Ti po thuesh i keni blerë pesë automjete. Shumë herë e ke përmend, jo i keni blerë të vjetra, jo ka ec 40 kilometër. E prumë dokumentacionin, mundesh me e pas në dorë edhe do të bindesh. Për atë edhe delegatët nuk e pranuan kërkesën tënde, se nuk je i sinqertë. Në start po thuesh që i keni blerë pesë automjete, a unë e di që ne automjete në Komunë nuk kemi ble, i kemi trashëgue automjetet nga qeveria e kalume, nuk kemi pas nevojë me ble

automjete tjera edhe nuk kemi blerë. Sa u përket vaksinave, e dish që ka mundësi të bëhen edhe gabime teknike, kështu që mos e bën shumë këtë punën tragjike. Por po të them edhe diçka, zyrtarisht ende epidemia e Covid-it nuk është e mbyllur. Ende kemi raste të Covid-it, falë Zotit që nuk kemi raste të shumta, por megjithatë ka ende Covid. Nëse i kam mbet dikujt pa ju përgjegj, unë mund të dal edhe një herë. Faleminderit!

**Nexhat Selaj:** Kryetar, nga sinqeriteti po ju drejtohem. S'un po e përmendi një fjalë, por po them dikush, ose unë ose ju, nuk po e tregojmë të vërtetën. Unë banorët e fshatit i pata këtu para 15 minutave. Nëse bëhet fjalë për Kryesinë: Nehar Krrabaj, Ruzhdi Qollopeku dhe Bedri Ajupi, nuk është fare e vërtetë se ata drejtohen se unë nuk jam banor i fshatit Zym, pasi unë me ata kam komunikue. Kështu që, për sinqeritet, mbetet të ma sigurosh një termin nesër, apo një ditë kur të kesh qef ti, unë do të vij bashkë me Kryesinë e fshatit, edhe kam qef për hir të transparencës dhe sinqeritetit, si mësues, kam qef me të kërkue falje kështu publikisht, të kërkoj, të them më fal. Por, nëse nuk është e vërtetë, kam qef me dalë publikisht me m'thënë më fal. Kjo sa i përket pyejtes së dytë ishte, që nuk e ndjeva veten mirë. Me ato fjalë që të paskan thënë ata – nuk jam banor i fshatit Zym – unë jam i Zymit edhe zymjan, edhe e quaj veten të Zymit edhe kam me vdek në Zym. Sa i përket përgjigjes së parë, prapë nuk është përgjigje. Ju më keni thënë se do ta sjellim ligjin i cili lejon transferin e nxënësve. Unë asgjë nuk kërkova, vetëm ta shoh qat ligjin. Atë ligj unë e kam, për atë arsye të kam thënë nuk lejohet transferi i nxënësve nga një shkollë të një paralele tjetër, në shkollë me paralele tjetër. Për atë arsye unë kam kërkue. Po besoj që drejtori juaj, apo ju, prapë në seancën tjetër kam me ta kërkue këtë, se po na shkaktohen seriozisht probleme të mëdha. Asnjë nxënës tjetër më s'ka me ardhë me konkurrue këtu në Mjekësi, se e di se s'un pranohet. Shkon lajmërohet në Prizren, regjistrohet në Ekonomi, e tani na vjen neve në Mjekësi. Më fal! Faleminderit!

**Bexhet Xheladini:** Dëshmia më e madhe janë mjetet e informimit. Ata më kanë dëgjue edhe mu, ju kanë dëgjue edhe juve. Po mund të jenë dy të vërteta, edhe ti mundesh me pas të drejtë, edhe unë. Unë të garantoj që mu, qata tre persona që i përmende, kanë qenë në zyrë te unë edhe m'i kanë thënë qeto fjalë që t'i thashë unë. Po nuk ua ka ndalue askush atyre që me t'i thënë edhe ty qato informata. Kështu që, nuk kemi nevojë ne me bo gjyq, po unë dëshmitar e kam kamerën. Ata mu më kanë thënë kështu. Se jemi zënë edhe për një kanal, një ujëmbledhës aty, edhe e kemi çelë edhe problemin e ujëmbledhësit, edhe ata m'i thanë qeto fjalë që t'i thashë më herët. Kështu që, unë po të besoj që janë dy të vërteta, ata mu më kanë thënë 1 milion përqind qashtu, por të kanë

thënë edhe ty, kështu që edhe ti ke të drejtë. S'po të them unë që s'ke të drejtë, po unë të trëgova qysh më kanë thënë mu. Faleminderit!

**Munir Jonuzi:** Projekti për karrigen stomatologjike për personat me nevoja të veçanta, komuna e financon me 40%, ndërsa Advance me 60%. Pse atëherë zyrtarët tuaj thonë që kjo karrige është në bashkëpunim me UNMIK-un që qenka pjesërisht donator? Çfarë fondesh jep UNMIK-u? Kam pyetur nga dolën 31,000 euro për shërbime mjekësore, kjo karrige, furnizimi mjekësor – nuk është vetëm ajo, edhe testi Papa. Tani më intereson rregullimi i dhomës së Muzeut Kombëtar, edhe kjo përfshihet. Mjafton vetëm të më jepni dokumentet. Ju jeni shumë transparent, i publikoni të gjitha vendimet tuaja – për tenderët nuk publikoni, ende asnjë nuk është publikuar. Më intereson ku është vendimi për bashkëpunimin me Advance Together apo me UNMIK-un. Në uebfaqe nuk e keni. Nuk ka pasur asnjë vendim për këtë, sikurse për parqet e fëmijëve në Dragash, Krstac, Krushevë. Vlera totale e kontratës është 30,000 euro, nga të cilat ne kemi paguar 20,000, dhe ato 11,000 janë për reagentë – po ku është kontrata për barna prej 13,000 euro? Pres nga ju këto Vendime.

**Artan Loshaj:** E di që u zgjat shumë, një pyetje kryetar, pata me ia bo drejtorit të Shëndetësisë, po nuk është. Ma herët e potencove, rreth pacientave për dializën diçka, e përmende në fillim. Qysh është gjendja me pacientët e dializës, se thaje dy automjete i kemi e tash po na duhet edhe një automjet i tretë. Problemi është – e dish se je mjek ti, edhe mos ta diskutojmë, se nuk më takon para teje – ata janë me një gjendje shëndetësore, se qashtu i ka sprovue Allahu. Problemi është aty – po due me e pyet drejtorin, po masi je kryetar ti edhe doktor, mundesh me më dhënë përgjigje – pse shoferi i Komunës i bën vozitjen e pacientëve të QKMF-së, kur kemi plot punëtorë? Qe 26 vite unë punoj, kurrë nuk i ka vozit tjetërkush. Një punëtor i Komunës me i vozit pacientët e QKMF-së, kur kemi plot shofera edhe, të thashë, kemi urdhër edhe infermierët me e bo vozitjen e autoambulancave. E dyta, në qoftë se ka mundësi, se për ta me e dhënë maksimumin duhet, te disa pacienta shkojnë me kerr, i merret në shpi pacienti, shkon në Prizren, e kthen deri në shpi, e disa të tjerë presin, për shembull, prej Lubovishtit vjen në Dragash, e prej Shajnes në Dragash, e prej Rrencit në Dragash, prej Orqushës e pret në rrugë kryesore, e disa të tjerë – këtë pyetje po due me ia bo drejtorit, në qoftë se s'mundish më më dhënë përgjigje, në seancën tjetër pres, nuk është problem. Si është e mundur dikujt me i shkue në shpi, me e marrë – në këtë kohë, për shembull, dimrit, në minus, shkon në ora 6 e merr, e tjetërkush e pret në rrugë, ose verës kur kthehet dializës, ora 12 e gjys a 1 kthehen, është 35 temperatura, ai e pret ose familjarin, ose e pret taksin. Në qoftë se ka mundësi – vetë thaje që do ta angazhojmë edhe veturën e tretë – është mirë, se e di shumë

mirë, jam punëtor shëndetësor, një kerr shkon shoferi prej Radeshës në Krushevë e merr pacientin, tjetrin e merr në Orqushë edhe vjen në Dragash, këta tjerët mblidhen këtu para spitalit edhe shkojnë. Tjetri shkon prej Zaplluxhes –unë e kam pa para dy a tri ditëve qetu, kanë pas një shqetësim, kanë qenë te ti, s’di a kanë bo zgjidhje, se edhe ma herët kanë bërë kërkesë. Disa të tjerë ankohen se prej Zaplluxhes – po më vjen keq për pacientët – me oksigjen, vjen në Bresanë, vjen deri të ura e Rrencit, e merr atë të Rrencit. Tash është problem, është edhe një pacient i ri, është nga Dragashi, vjen autoambulanca prej Zaplluxhes, me të sëmurë, vjen në Dragash e merr pacientin, kthehet, me të sëmurë, qysh janë të lodhur, e dish shumë mirë, kthehet prapë deri në Dragash, e kthen edhe e çon në Zaplluxhe. Këtë veturën e tretë në qoftë se e angazhoni, është mirë, Dragash-Lubovishtë-Rrenc, me i mbledhë qata pacientët qysh po i mbledhni në Krushevë edhe në vendet tjera, edhe me e bo transportin, mos me iu bo barrë edhe shumë familjarëve, se e dish, ata shkojnë edhe me përcjellësa. Faleminderit!

**Bexhet Xheladini:** Ky projekt ka ardhë si rezultat i punës së Zyrës për Komunitet dhe Kthim, në bashkëpunim me UNMIK-un, financues është UNMIK-u, mirëpo mjetet janë të bartura te qekjo shoqata që ia përmenda emrin. Ne, për mos me e humb këtë projekt shumë të rëndësishëm, kemi gjetur një formë që edhe pa i pas mjetet – se ka pozicion të posaçëm, ku Asambleja duhet me votue, me qenë në atë pozicionin mjete për bashkëfinancim. Ato mjete janë harxhues në projektin që thashë më herët, për rregullimin e tensionit të lartë të rrymës në drejtim të Restelicës – ne atëherë e kemi marrë e kemi bo këtë në bazë të Mallrave dhe Shërbimeve. Kshtu që, këto janë ato mjete të cilat kanë mund të shkojnë edhe prej shëndetësisë, të shkojnë një pjesë e vogël e mjeteve edhe në kulturë, por megjithatë janë mjete të buxhetit komunal edhe ne kemi pas për qëllim që të mos e humbim këtë projekt shumë të rëndësishëm. Ishte fjala për Papa Testin dhe disa projekte tjera të rëndësishme. Ky projekt ka fillue dhe është duke shkue shumë mirë. Sa u përket pacientëve të dializës, ju e dini se ti je vetë profesionist shëndetësor, sa herë lind ndonjë pacient i ri i dializës, procesi të cilin e ke pas çrregullohet. Derisa ai proces të rregullohet mund të ndodhin këso gjëra, si na kanë ndodhë në atë rastin ku është dashtë prej Zaplluxhes me ardhë në Dragash me e marrë një rast. Mirëpo, kjo ka ndodhë dy – tri ditë ose dy – tri herë dhe pastaj ky proces është rregullue, drejtori i Shëndetësisë ka gjet mundësi me e rregullue. Mirëpo, në të ardhmen do të punojmë në atë drejtim, që sa më afër pacientëve t’u ofrojmë shërbime shëndetësore, që shkojmë t’i marrim edhe nëpër shtëpi, megjithëse mundësitë janë... nuk mundesh qindpërqind të gjithëve me ua realizue, sepse atëherë u bjer njerëzve me i bart prej një fshati në fshatin tjetër. Po megjithatë, me

pacientët e dializës tash është gjet një gjuhë e përbashkët, dhe nga ana e tyre nuk ka ankesa. Pse vozit shoferi i Komunës? Ju e dini se para dy viteve i kemi pas dy autobusë të cilët kanë bërë transportin e nxënësve, edhe ata kanë qenë shofera të autobusit. Pasi janë shofera të Komunës, është njëlloj. Me rëndësi është shofer i institucionit, ata i shfrytëzojmë tash edhe për bartjen e pacientëve të dializës, këtu unë nuk shoh që ka diçka të keqe. Pyetja nuk është edhe aq adekuate, por unë jam i obliguar që t'ju jap përgjigje. Faleminderit!

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit! E mbyllim këtë seancë!